



Zyra për institucione demokratike dhe të drejtat e njeriut

**ISH REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË**

**ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PARLAMENTARE**  
**1 qershor 2008**

**Misioni vëzhgues i zgjedhjeve OSBE/ODIHR**  
**Raporti përfundimtar**



Varshavë  
20 gusht 2008

## PËRMBAJTJA:

<b>I.</b>	<b>PËRMBLEDHJE</b> .....	<b>1</b>
<b>II.</b>	<b>HYRJE DHE FALËNDERIME</b> .....	<b>2</b>
<b>III.</b>	<b>HISTORIATI</b> .....	<b>3</b>
<b>IV.</b>	<b>KORNIZA LIGJORE</b> .....	<b>4</b>
<b>V.</b>	<b>ADMINISTRATA E ZGJEDHJEVE</b> .....	<b>5</b>
A.	ORGANËT PËR ADMINISTRIM TË ZGJEDHJEVE.....	5
1.	<i>Komisioni shtetëror zgjedhor</i> .....	5
2.	<i>Komisionët komunale zgjedhore dhe Këshillet zgjedhore</i> .....	6
B.	EDUKIMI I VOTUESVE .....	7
C.	LISTAT E VOTUESVE .....	8
D.	REGJISTRIMI I LISTAVE TË KANDIDATËVE .....	8
<b>VI.</b>	<b>FUSHATA ZGJEDHORE</b> .....	<b>9</b>
A.	KORNIZA LIGJORE PËR ZHVILLIMIN E FUSHATËS .....	9
B.	ZHVILLIMI I FUSHATËS.....	10
C.	AMBIENTI I SIGURISË .....	10
D.	ÇËSHTJE SHETËTËRORE DHE PARTIAKE .....	11
E.	FINANCIMI I FUSHATËS .....	11
<b>VII.</b>	<b>MEDIAT</b> .....	<b>12</b>
A.	AMBIENTI I MEDIAVE.....	12
B.	KORNIZA LIGJORE.....	12
C.	MBULIMI I FUSHATËS.....	13
D.	MVZ OSBE/ ODIHR VËZHGIMI I MEDIAVE .....	14
<b>VIII.</b>	<b>ANKESAT DHE APELIMET PARAZGJEDHORE</b> .....	<b>15</b>
<b>IX.</b>	<b>PJESEMARRJA E GRAVE</b> .....	<b>16</b>
<b>X.</b>	<b>PJESEMARRJA E BASHKESIVE ETNIKE</b> .....	<b>17</b>
<b>XI.</b>	<b>VËZHGUESIT VENDORË</b> .....	<b>17</b>
<b>XII.</b>	<b>VËZHGIMI NË DITËN E ZGJEDHJEVE</b> .....	<b>18</b>
A.	GJENDJA E SIGURISË.....	18
B.	VOTIMI .....	19
1.	<i>Votimi i hershëm</i> .....	19
2.	<i>Votimi në ditën e zgjedhjeve</i> .....	19
C.	NUMËRIMI .....	20
D.	PËRLLOGARITJA .....	20
<b>XIII.</b>	<b>ZHVILLIMET POST-ZGJEDHORE</b> .....	<b>21</b>
A.	ZHVILLIMET POLITIKE .....	21
B.	ANKESAT DHE APELET POST-ZGJEDHORE .....	22
C.	RIVOTIMET .....	22
<b>XIV.</b>	<b>ZHVILLIMET PAS RIVOTIMIT</b> .....	<b>24</b>
<b>XV.</b>	<b>REKOMANDIME</b> .....	<b>25</b>
A.	KORNIZA LIGJORE .....	25
B.	ADMINISTRATA E ZGJEDHJEVE .....	26
C.	REGJISTRI I VOTUESVE.....	27
D.	FUSHATA ZGJEDHORE .....	27
E.	DITA E ZGJEDHJEVE DHE PROCEDURAT E VOTIMIT .....	28
F.	MEDIAT .....	28
<b>SHTOJCA 1 – REZULTATET PËRFUNDIMTARE</b> .....	<b>29</b>	
<b>RRETH OSBE/ODIHR-IT</b> .....	<b>30</b>	

**ISH REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË**  
**ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PARLAMENTARE**  
**1 qershor 2008**

**Misioni vëzhgues i zgjedhjeve OSBE/ODIHR Raporti Përfundimtar**

**I. PËRMBLEDHJE**

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë u mbajtën më 1 qershor 2008. Pas pranimit të ftesës nga Ministria e punëve të jashtme dërguar më 14 prill 2008, OSBE/ODIHR-i më 30 prill 2008 themeloi Mision Vëzhgues për zgjedhjet për të vlerësuar nëse procesi zgjedhor është në përputhshmëri me Dokumentin e Kopenhagës të OSBE-së, të vitit 1990 dhe standardeve të tjera ndërkombëtare, si dhe me legjislacionin vendor.

Zgjedhjet e parakohshme të 1 qershorit u ofruan votuesve një llojllojshmëri zgjedhjesh gjatë fushatës zgjedhore të zhvilluar në mënyrë shumë energjike. Në pjesën më të madhe të vendit zgjedhjet u drejtuan mirë nga ana procedurale. Megjithatë, pritjet për progres nuk u arritën për shkak të dështimit nga disa palë që merrnin pjesë në zgjedhje dhe autoriteteve përkatëse për të parandaluar aktet e dhunshme kryesisht në zonat me shumicë shqiptare, duke përfshirë këtu edhe zbatimin e kufizuar dhe selektiv të ligjeve. Përpjekjet e organizuara për ta penguar procesin zgjedhor në orët e mëngjesit gjatë ditës të votimit, pamundësuan shumë qytetarë në shumë vende të shprehin lirisht vullnetin e tyre.

Si rezultat i kësaj dhe pas shqyrtimit të hollësishëm të ankesave nga ana e Komisionit Shtetëror Zgjedhor (KSHZ-së), më 15 qershor, zgjedhjet u përsëritën në 187 vendvotime, dhe më pastaj, më 29 qershor, edhe në 15 vendvotime. Kjo u dha mundësi votuesve të prekur nga parregullsitë serioze që ndodhën më 1 qershor të shprehin vullnetin e vet në një ambient më të sigurt dhe përgjithësisht më të qetë. Kjo u sigurua nga prezenca e madhe e forcave policore përbrenda dhe përreth vendvotimeve. Megjithatë, tensionet dhe frikësimet mbetën të dukshme në periudhën e përkohshme që u parapriu rivotimeve, Në përgjithësi, zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 2008-ës nuk i plotësuan obligimet kyçe të OSBE-së.

Në përgjithësi, Kodi zgjedhor siguron bazë të shëndoshë për administrimin e zgjedhjeve demokratike. Megjithatë, përmban disa dispozita të paplota dhe kontradiktore, posaçërisht në lidhje me procesin e ankesave dhe apeliemeve. Përveç kësaj, legjislacioni që ka të bëjë me financimin e fushatës nuk kërkon vërtetim të të dhënave për financim të fushatës të cilat janë dorëzuar nga ana e pjesëmarrësve në zgjedhje. U shqyrtuan disa hapa për korrigjimin e këtyre dispozitave, mirëpo ky proces u ndërpre nga zgjedhjet e parakohshme.

Organet e administrimit të zgjedhjeve u përballën me sfida të rëndësishme gjatë procesit zgjedhor. KSHZ-ja punoi në mënyrë efikase, edhe pse pati kornizë kohore të shkurtuar dhe rivotimeve që pasuan. KSHZ-ja gjithashtu funksionoi përgjithësisht në mënyrë kolegjinale dhe të paanshme, edhe përpos shtypjes që thuhet se është ushtruar mbi disa anëtarë të tij. Në raste kur përballlej me vendime të vështira, KSHZ-ja zakonisht përpigjej të gjejë zgjidhje kompromisi. Megjithatë, disa prej vendimeve të KSHZ-së nuk dukej se janë në përputhshmëri me Kodin zgjedhor.

Komisionet komunale zgjedhore (KKZ-të) u përballën me kufizime në efikasitetin e punës së tyre, pjesërisht për shkak të asaj se nëpunësit civil dhe publik që i përbënin KKZ-të nuk u liruan nga detyrat e tyre deri kah fundi i procesit zgjedhor, dhe në disa raste ishin stacionuar jashtë bashkësisë ku jetojnë vetë. Në disa pjesë të shtetit, edhe KKZ-të dhe Këshillat zgjedhor përkatës (KZ-të) në nivel të vendvotimeve, gjithashtu të përbërë nga nëpunës shtetëror, u përballën me presion të madh gjatë ditës së zgjedhjeve nga burime zyrtare dhe jozyrtare.

Një garë intensive politike u zhvillua në mes të dy koalicioneve të mëdha që kryesisht i përfaqësonin bashkësitë etnike maqedonase, si dhe në mes të dy partive më të mëdha shqiptare. Shumica e bashkësive etnike më të vogla iu bashkuan koalicionit të udhëhequr nga maqedonasit etnik.

Gjatë fushatës u përdorën edhe reklama nëpër media, lajmërimet politike dhe fjalime publike. Kjo i ofroi kandidatëve burime të shumëllojshme për t'u njoftuar me programet e kandidatëve. Transmetuesit publik, megjithatë, ishin në favor të partive qeveritare, dhe paralajmërimet dhe sanksionimet nga ana e Këshillit për Radiodifuzion gjatë fushatës ishin joefektive.

Dallimi mes strukturave shtetërore dhe atyre partiake në disa raste u bë i paqartë, siç u ilustrua me shembull me fushatën reklamuese të hapur nga autoritet pak kohë para fushatës zyrtare që i reklamonte sukseset e iniciativave të Qeverisë, si dhe programet e Qeverisë që siguronin shërbime speciale për qytetarët gjatë periudhës së fushatës.

Partitë etnike shqiptare u përfshinë në një retorikë të ashpër e cila ndonjëherë çonte drejt dhunës. Numri i madh i incidenteve të dhunshme kryesisht në rajonet etnike shqiptare para dhe gjatë periudhës zyrtare të fushatës krijuan një ambient frikësimi. Dështimi në marrjen e aksioneve parandaluese iu mvesh, nga shumë bashkëbisedues tanë, zyrtarëve të lartë të policisë në veri dhe përfundim të vendit të cilët haptazi e mbështetnin njërin parti të shqiptarëve etnik. Fakti se aktet e tilla mbetën të pashqyrtuara nga ana e autoriteteve përgjegjëse lokale dhe nacionale kontribuoi në krijimin e një kulture të mosndëshkimit gjatë zgjedhjeve të 1 qershorit.

Kodi zgjedhor përkrah një përfaqësim më të balancuar të gjinive në procesin zgjedhor. Femrat përfaqësojnë 30 % të Parlamentit të ri. Përveç kësaj, femrat janë përfaqësuar më shumë në organet drejtuese zgjedhore, posaçërisht në nivele më të ulëta.

Në ditën e zgjedhjeve, dhuna e organizuar dhe frikësimi e trazuan votimin në rajonet e banuara kryesisht me shqiptarë etnik, dhe rezultuan në vdekjen e një personi dhe disa të plagosur. Kjo i kontribuoi një numri të parregullsive dhe rasteve të mashtrimeve zgjedhore. Të gjitha ngjarjet e lartë përmendura ndikuan në lirinë e votuesit për të votuar pa frikësime, dhunë ose frikë nga hakmarrja. Edhe pse Ministria e punëve të brendshme në fillim ngurroi t'i marrë në përgjegjësi individët e përfshirë në manipulimet e ditës së zgjedhjeve, u mundua ta kontrollojë situatën e sigurisë gjatë rivotimeve të 15 qershorit dhe siguroi një situatë përgjithësisht më të qetë.

## II. HYRJE DHE FALËNDERIME

Më 14 prill 2008, pas një ftese prej Ministrisë së punëve të jashtme, më 30 prill 2008, OSBE/ODIHR themeloi Mision për Vëzhgimin e zgjedhjeve (MVZ) në Shkup. MVZ-ja e

OSBE/ODIHR u kryesua nga Ambasadori Robert Barry dhe në fillim përbëhej nga një ekip 13 anëtarësh i bazuar në Shkup. Më 6 maj, 20 vëzhgues afatgjatë u stacionuan gjithandej vendit.<sup>1</sup>

OSBE/ODIHR i bashkoi forcat me Asamblenë Parlamentare të OSBE-së (AP SBE) si dhe me Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKE) që të formojnë Misionin ndërkombëtarë për vëzhgimin e zgjedhjeve (MNVZ) për vëzhgimin e ditës së zgjedhjeve. Znj. Pia Christmas-Møller (Danimarkë), Nënkrjetare e Asamblesë Parlamentare të OSBE-së dhe Shefe e Delegacionit të AP OSBE-së, u caktua si Koordinatorë Speciale nga ana e Shefit të lartë të OSBE-së për të udhëhequr me vëzhguesit afatshkurtër të OSBE-së. Z. Mevlüt Çavuşoğlu (nga Turqia) u caktua për ta udhëhequr delegacionin e APKE-s.

Në ditën e zgjedhjeve, MNVZ-ja stacionoi vëzhgues prej 42 vendeve pjesëmarrëse të OSBE-së, përfshirë edhe 214 vëzhgues të OSBE/ODIHR-it, Delegacion prej 19 vetëve nga AP OSBE-ja dhe Delegacion prej 13 vetëve të APKE-s. MNVZ-ja i vëzhgoi zgjedhjet në 1 176 vendvotime, si dhe numërimin e votave në 112 vendvotime (nga gjithsej 1 976 vendvotimeve). MNVZ-ja gjithashtu e vëzhgoi edhe mbartjen e rezultateve deri të KKZ-të dhe mbledhjen e rezultateve në tabela në 73 KKZ (nga gjithsej 84 KKZ). Gjatë rivotimeve të 15 qershorit, MNVZ-ja u riformua, dhe stacionoi 39 ekipe vëzhguese të përbërë nga 72 vëzhgues afatshkurtër të OSBE/ODIHR-it, delegacion 4 anëtarësh të AP OSBE-së dhe delegacion 2 anëtarësh të APKE-s, të cilët vizituan 160 vendvotime (nga gjithsej 187 vendvotimeve ku u përsëritën zgjedhjet).

OSBE/ODIHR-i falënderon Ministrinë e punëve të jashtme për ftesën për t'i vëzhguar zgjedhjet, Komisionin shtetëror zgjedhor për atë se siguroi dokumentet akredituese, si dhe autoritetet e tjera shtetërore dhe lokale për ndihmën dhe bashkëpunimin e tyre. OSBE/ODIHR-i gjithashtu dëshiron të falënderojë Misionin Vëzhgues të OSBE-së në Shkup për bashkëpunimin gjatë gjithë periudhës kur ishte Misioni, si dhe Ambasadat rezidentë të shtatëve pjesëmarrëse në OSBE dhe institucionet e tjera ndërkombëtare.

### III. HISTORIATI

Në përputhshmëri me Kushtetutën, Parlamenti i ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë votoi për shpërbërjen e vet më 12 prill 2008, dhe Kryetari i Parlamentit paralajmëroi zgjedhje të parakohshme për 1 qershor 2008. Bashkimi Demokratik për Integritim (BDI), parti opozitare, e dorëzoi propozimin për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme me pretendimin që të dilet nga qorrsokaku në Parlament. Fakti se Qeverisë i mungonin shumica e dyfishtë<sup>2</sup>, dhe se Partia Demokratike Shqiptare (PDSH) më herët kishte dalë nga koalicioni qeveritar, e vështirësoi sjelljen e legjislacionit që kërkohet me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit (dhe e cituar si parakusht për fillimin e bisedimeve për anëtarësim në Bashkimin Evropian/ BE). Faktori tjetër që ndikoi mbi situatën politike ishte në lidhje me ofrimin e pasuksesshëm të ftesës për anëtarësim të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë në NATO gjatë muajit prill.

<sup>1</sup> OSBE/ODIHR-i publikoi raport të përkohshëm një ditë para ditës së zgjedhjeve, deklaratë për konkluzionet një ditë pas zgjedhjeve, dhe deklaratë për shtyp pas rivotimeve të 15 qershorit. Të gjitha raportet janë në dispozicion në internet faqen: [www.osce.org/odihr-elections/31282.html](http://www.osce.org/odihr-elections/31282.html)

<sup>2</sup> Në bazë të Kushtetutës të gjitha ligjet “të cilët prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë kulturën, përdorimin e gjuhës, arsimin, dokumentacionin personal, dhe përdorimin e simboleve” duhet të sillen me shumicë votash të Përfaqësuesve pjesëmarrës të cilat u takojnë bashkësive jo shumicë të popullatës”.

Propozimi për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme u mbështet nga partitë më të mëdha qeveritare, Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Bashkim Nacional Maqedonas (VMRO-DPMNE) dhe Partia Demokratike Shqiptare (PDSH). Vendimi u kundërshtua nga partitë opozitare maqedonase – Lidhja Social Demokratë e Maqedonisë (LSDM) dhe Partia Demokratike Liberale (PDL). Votimi gjithashtu u kundërshtua nga disa partnerë më të vegjël të koalicionit qeveritar – Partia e Re Social Demokratë (PRSD) dhe Partia Liberale (PL), të cilat së bashku me opozitën debatuan se zgjedhjet e parakohshme do të shtynin edhe më shumë reformat e shtruara si kusht për fillimin e bisedimeve për anëtarësim në BE.

Autoritetet qeveritare gjatë deklaratave publike premtuan angazhimin e tyre në plotësimin e detyrimeve dhe standardeve ndërkombëtare për zgjedhjet pas një situatë kur Bashkësia ndërkombëtare apelonte në mënyrë aktive se pret që zgjedhjet të jenë demokratike, dhe pa dhunë dhe frikësime. Më 8 maj, me patronazh të Institutit Nacional Demokratik, me bazë në Uashington, të gjitha partitë politike që merrnin pjesë në zgjedhje nënshkruan Kodeksin për mirësjellje. Palët nënshkruese u përkushtuan se do të “promovojnë zgjedhje të lira dhe korrektë dhe klimë të tolerancës demokratike” dhe se do të “ndëshkojnë publikisht dhunën dhe frikësimet”<sup>3</sup>.

Që nga viti 2002, zgjedhjet parlamentare janë mbajtur sipas modelit zgjedhor proporcional, në gjashtë njësi zgjedhore, të cilat përmbajnë përafërsisht numrin e njëjtë të votuesve të regjistruar, me 20 Deputetë Kuvendit të zgjedhur në secilën njësi. Njësitë zgjedhore nuk u përgjigjen njërive administrative/ territoriale ekzistuese, por përgjithësisht u përmbahen kufijve komunal. Qëllimi i kësaj qasjeje ishte ta përforcojë stabilitetin në përgjithësi nëpërmjet fokusimit në rivalitetin politik brenda në bashkësitë. Në disa njësi zgjedhore – kryesisht rajone etnike shqiptare – ka qenë i dukshëm një rivalitet intensiv mes partive gjatë zgjedhjeve.

#### IV. KORNIZA LIGJORE

Korniza ligjore zgjedhore është kryesisht e përmbajtur në Kodin Zgjedhor, i cili hyri në fuqi para zgjedhjeve parlamentare të vitit 2006. Ligji siguron baza kryesisht të shëndosha dhe të barabarta për realizimin e zgjedhjeve demokratike, megjithëse përmban disa dispozita të pakompletuara dhe kontradiktore.

Kodi zgjedhor nuk është ndryshuar qëkur është miratuar. Një numër amendamentesh u dorëzuan nga Ministria e drejtësisë (MD) në vitin 2007<sup>4</sup>, por nuk kaluan në legjislacion. Në vitin 2008 Ministria përgatiti amendamente plotësuese<sup>5</sup>, por ato nuk u dorëzuan në Parlament përpara se ai të shpërbëhej.

Disa ligje që kanë ndikim në procesin zgjedhor, dhe në disa raste nuk janë në përputhshmëri me Kodin, u miratuan që nga viti 2006, kur hyri në fuqi Kodi Zgjedhor. Mospërputhshmëria

---

<sup>3</sup> Kodeksi për mirësjellje për zgjedhje parlamentare të lira dhe demokratike, nënshkruar më 8 maj 2008, në Shkup

<sup>4</sup> Në lidhje me banimin e përkohshëm dhe votimin jashtë vendit, financimin e fushatës zgjedhore dhe kundërvajtjet zgjedhore.

<sup>5</sup> Në lidhje me ankesat ligjore, regjistrimin e votuesve, financimin e fushatave dhe procedurave për kundërvajtje.

më serioze ka të bëjë me ankesat ligjore. Në bazë të Kodit zgjedhor, ankesat për vendime të caktuara të Komisionit Shtetëror Zgjedhor (KSHZ) parashtrohen në Gjykatën Supreme. Ligjet që janë miratuar më vonë për Gjykatat dhe Kontestet<sup>6</sup> Administrative ia përcaktojnë Gjykatës Administrative juridiksionin për ankesat zgjedhore. Kjo Gjykatë ka autoritet të shqyrtojë ankesa në vendime të bëra nga organe administrative të shkallës së parë<sup>7</sup>, përfshirë këtu edhe ankesa për procedurën e KSHZ-së.

KSHZ-ja kërkoi këshillë prej Institucioneve shtetërore dhe mori mendime kontradiktore nga Ministria e drejtësisë dhe Gjykata Supreme. KSHZ-ja vendosi që t'i transmetoi të gjitha ankesat tek Gjykata Supreme. Vendimi i KSHZ-së u pranua nga Institucionet shtetërore dhe palët e përfshira në zgjedhje. Interpretimi i ngushtë i kompetencave të Gjykatës Supreme në raste që kanë të bëjnë me zgjedhjet, megjithatë, i përjashtoi ankesat që nuk autorizohen veçanërisht nga Kodi Zgjedhor. Me këtë u krijua zbrazëti në mbrojtjen e të drejtave të kandidatëve në zgjedhje (shih pjesën mbi Ankesat dhe Apelet parazgjedhore).

Një kundërshtim ligjor tjetër rezultoi nga miratimi i Ligjit për kundërvajtje të vitit 2006. Në bazë të Ligjit, KSHZ-ja nuk është e autorizuar të ndërmarë procedurë ndaj atyre që kryejnë kundërvajtje<sup>8</sup> zgjedhore. Meqë me Kodin Zgjedhor, KSHZ-ja është akoma e autorizuar të bëjë këtë, është e paqartë a do ta marrin këtë përgjegjësi organet e autorizuar për ato.

## V. ADMINISTRATA E ZGJEDHJEVE

### A. ORGANET PËR ADMINISTRIM TË ZGJEDHJEVE

Kodi Zgjedhor parasheh administratë zgjedhore me tri shtylla të drejtuar nga KSHZ-ja, nga 84 Komisione Komunale Zgjedhore (KKZ) dhe nga 2,976 Këshille Zgjedhore (KZ). Që nga viti 2006, KSHZ-ja ka ekzistuar si trup i përhershëm që mbikëqyr përgatitjet e përgjithshme për zgjedhjet, e përbërë prej 7 anëtarëve për periudhë pesë vjeçare. KKZ-të mbajnë përgjegjësi për mbikëqyrje të procesit zgjedhor në çdo komunë dhe gjithashtu zgjidhen me mandat pesë vjeçar. KZ-të zgjidhen për katër vite, dhe secili prej tyre mban përgjegjësi për vendvotimin një ditë para zgjedhjeve dhe gjatë ditës së zgjedhjeve.

#### 1. Komisioni shtetëror zgjedhor

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2008 ishin zgjedhjet e dyta të drejtuar nga kjo përbërje e KSHZ-së<sup>9</sup>. MVZ-ja dhe OSBE/ODIHR-i konstatuan se KSHZ-ja ka punuar në mënyrë efikase, pavarësisht nga ajo se ka punuar në kornizë kohore të shkurtuar dhe ka pasur rivotime. Dispozitat e Kodit zgjedhor për zgjedhje të parakohshme i shkurtojnë shumicën e afateve të proceseve zgjedhore për pesë ditë.

<sup>6</sup> Këto ligje janë gjithashtu ligje organike, dhe kërkojnë mbështetje të 2/3 së shumicës në Parlament (Amendamenti Nr. 25).

<sup>7</sup> Ligji mbi kontestet administrative, Neni 8.

<sup>8</sup> Përderisa Kodi e autorizoi KSHZ-në të "inicijë dhe udhëheqë" me procedurat për kundërvajtje (Kodi Zgjedhor, Neni 31.3), Ligji për kundërvajtje bën dallim në mes Organeve shtetërore të autorizuar për inicim të procedurave dhe ato ("organe të kundërvajtjes") të cilët gjithashtu mundën t'i udhëheqin ato.

<sup>9</sup> KSHZ-ja u zgjodh në vitin 2006, përpara zgjedhjeve të fundit parlamentare dhe nuk ka pasur asnjë ndryshim në anëtarësinë e KSHZ-së prej votimit në Parlament më 17 prill 2006.

KSHZ-ja gjithashtu punoi përgjithësisht në mënyrë kolegjinale dhe të paanshme, edhe përpos presionit ndaj disa anëtarëve të tij. Gjatë periudhës përgatitore të zgjedhjeve të parakohshme të 1 qershorit, partitë opozitare kërkuan dorëheqjen e Kryetarit të KSHZ-së, meqë ai ishte emëruar nga partia qeveritare, VMRO-DPMNE<sup>10</sup>. Kryetari i KSHZ-së pohoi se është zgjedhur për mandat pesë vjeçar dhe se do të ishte një akt i papërgjegjshëm nëse jep dorëheqje pak kohë para zgjedhjeve. Pas zgjedhjeve të 1 qershorit, gjatë periudhës së ankesave, u bë presion edhe ndaj dy anëtarëve të KSHZ-së të cilët ishin emëruar nga partitë e shqiptarëve etnik.

KSHZ-ja është orvatur që të arrijë konsensus gati se në çdo vendim, që shpesh rezultonte në debate të stërzgjatura. Kur përballej me interpretime të ndryshme të Kodit Zgjedhor, KSHZ-ja përgjithësisht vendostë në qasjen më të kompromentuar. Në një rast, kjo do të thoshte se kriminelëve që kanë qenë më herët të dënuar t'u lejohet të kandidohen në listë zgjedhore (shih pjesën mbi Regjistrimin e listave të kandidatëve).

Seancat formale të KSHZ si dhe shumë mbledhje punë ishin të hapura për vëzhguesit ndërkombëtarë dhe vëzhguesit jo-partiak të vendit. Përfaqësuesit e autorizuar të parashtruesve të listave të kandidatëve morën pjesë vetëm në seancën e KSHZ-së ku hiqej lotaria për pozitën në fletëvotim dhe për shqyrtimin e ankesave post-zgjedhore.

KSHZ-ja takohej rregullisht me MVZ-në pranë OSBE/ODIHR-it dhe bashkëpunimi i KSHZ-së me MVZ-në ishte shembullor.

## 2. Komisionet komunale zgjedhore dhe Këshillat zgjedhor

KKZ-të dhe KZ-të kanë pesë anëtarë dhe pesë zëvendësime. Duke filluar në vitin 2006, anëtarët zgjidheshin rastësisht nga të punësuarit në shërbimet civile dhe publike. Megjithatë, si masë kalimtare, në vitin 2006 vetëm Kryetari dhe dy anëtarë të çdo Këshilli zgjedhor zgjidheshin në këtë mënyrë; dy të tjerët emëroheshin nga partitë politike. Kështu, sivjet përpara zgjedhjeve, u pa e nevojshme që të organizohet zgjedhja e dy anëtarëve të ri dhe zëvendësve të tyre për të gjitha KZ-të (një personel plotësues prej rreth 6000 vetë).

U zhvilluan direktiva për të siguruar përfaqësim etnik dhe gjinor në organet administrative zgjedhore të niveleve më të ulëta. Në komunat ku grupet etnike përbënin më shumë se 20 % të popullatës së përgjithshme, grupet etnike doemos të përfaqësoheshin me nga dy anëtarë në nivel të KKZ-ve dhe nga një në KZ-të. Numri i përfaqësuesve të grupeve etnike u rrit edhe më shumë në raste kur raportet ishin mbi 50%. Përveç kësaj, 30% të anëtarëve në të gjitha trupat administrativ zgjedhor duhej t'i takonin gjinisë që është më pak e përfaqësuar.

Këto direktiva sigurojnë shkallë të lartë të përfshirjes dhe vlen të përmendet se ata u arritën, sepse një numër i lartë i stafit duhej të rekrutohej nga një rezervë e kufizuar (nëpunës të shërbimeve civile dhe publike). Megjithatë, një numër i komunave kishte mungesë të nëpunësive të shërbimeve civile dhe publike me origjinë etnike që kërkohej dhe duhej të lëvizeshin njerëz prej vendeve jashtë komunës ku jetojnë<sup>11</sup>.

<sup>10</sup> Kodi Zgjedhor thotë se Kryetari duhet të emërohet nga partia më e madhe opozitare, kurse zëvendësi nga partia në pushtet. Megjithatë, Kodi gjithashtu thotë se anëtarët e KSHZ-së zgjidhen me mandat 5 vjeçar.

<sup>11</sup> Kjo rezultoi që 21 KKZ të kenë më shumë se gjysmën e anëtarëve të sjellë prej jashtë komunës dhe 11 KKZ të kenë 8 ose më shumë anëtarë nga jashtë.



KKZ-të filluan të takohen rregullisht vetëm dy javë përpara zgjedhjeve, më shumë për shkak të faktit se anëtarët nuk ishin liruar nga detyrat e tyre civile që të mundën të marrin pjesë në takimet e tilla. Gjithashtu u vërejt si pengesë dhe fakti se disa anëtarë të cilët nuk ishin banorë të komunës ku ishin caktuar nuk e flisnin gjuhën në të cilën realizoheshin takimet.

Pjesa më e madhe e KKZ-ve dhe KZ-ve ishin të hapur ndaj vëzhguesve dhe disa prej tyre kërkuan rritje të prezencës së tyre për rivotimet e 15 qershorit. Megjithatë, në rajonet ku MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vëzhgoi raste të manipulimit të zgjedhjeve (si p.sh: Tetovë dhe Saraj), kishte raste kur vëzhguesve u ishte dhënë vetëm qasje e kufizuar ose edhe ishin penguar të hyjnë në vendvotim.

Caktimi i nëpunësive të shërbimeve civile dhe publike nëpër nivelet më të ulëta të organeve administrative zgjedhore kishte për qëllim të ndjekë modelin jo-partiak të administrimit të zgjedhjeve në këto nivele. Sidoqoftë, meqë çështja e politizimit të shërbimeve publike ende ekziston, palët e involvuara kanë shprehur pikëpamje të ndryshme rreth këtij sistemi. Përveç kësaj, trajnimet për këto zgjedhje të parakohshme ishin të pamjaftueshme për shkak të kornizës kohore të shkurtuar. Një program trajnues për votim familjar dhe me ndërmjetësi me mbështetje të UNDP-së u organizua në mënyrë të kufizuar para zgjedhjeve, por vëzhguesit e MVZ-së të OSBE/ODIHR-it vërejtën ndikim të kufizuar për kohën që ishte në dispozicion.

Një numër i anëtarëve të KZ-ve në rajonet me tension të lartë politik kërkuan të lirohen nga pozitat e tyre përpara zgjedhjeve, duke thënë se kanë frikë nga dhuna e mundshme gjatë ditës së zgjedhjeve. Në Tetovë, për shembull, 50 persona (përfshirë 10 Kryetarë të KZ-ve) kërkuan të lirohen nga pozitat për shkaqe shëndetësore. Afër Bërvenicës, 5 nga 18 KZ-të thanë se nuk do të pranojnë të punojnë gjatë ditës së zgjedhjeve nëse policia nuk është vazhdimisht prezent në vendvotime – edhe pse kjo nuk sigurohet me ligj. Frika tek anëtarët e KZ-ve të vendvotimeve ku u përsëritën votimet u rrit edhe më shumë pas dhunës së ushtruar më 1 qershor, për këtë shkak shumica kërkuan të lirohen nga pozitat, duke përmendur edhe stres. KSHZ-ja u përgjigj me atë se kanë besim në planet e përmirësuar të sigurisë dhe theksuan se ishte pjesë e detyrës së tyre që kanë në pozitat e shërbimeve publike.

Edhe pse disa anëtarë të KZ-ve u vëzhguan më 1 qershor si pjesëmarrës aktiv ose pasiv në dhunën zgjedhore, duke përfshirë edhe mbushje të kutive, KSHZ-ja vendosi se nuk ka kohë të mjaftueshme për t'i zëvendësuar ato dhe të trajnojë anëtarë të rinj përpara rivotimeve dy javë më pas. Ato i shkarkuan Kryetarët e gjashtë KKZ-ve ku kishin ndodhur parregullsitë më të mëdha<sup>12</sup>. Ky hap krijoi konfuzion dhe fyerje tek disa anëtarë të KKZ-ve, të cilët mendonin se kryetarët nuk mbanin gjithmonë përgjegjësi për shkak të “presionit” të ushtruar ndaj tyre. Vëzhguesit e MVZ-së të OSBE/ODIHR-it vërejtën se KKZ-të treguan më shumë vendosmëri në parandalimin e shkeljeve gjatë rivotimeve, edhe pse KKZ-të thanë se kjo ishte për shkak të rritjes së prezencës së policisë dhe vëzhguesve, të cilat i pamundësuan kërcënimet.

## **B. EDUKIMI I VOTUESVE**

Para zgjedhjeve, KSHZ-ja zhvilloi fushatë për edukimin e votuesve në shtyp dhe televizion me kohëzgjatje prej nëntë ditëve në gjuhën maqedonase dhe shqiptare. Porositë që përcilleshin përmbanin mobilizim të votuesve, informata se si të hidhet vota dhe paralajmërime për manipulime zgjedhore dhe kërcënime. Përpos kësaj, dy OJQ nacionale gjithashtu zhvilluan fushata për edukim të votuesve në televizion dhe shpërndanë fletushka.

<sup>12</sup> Kjo u paraqit në Saraj, Likovë, Tetovë, Bërvenicë, Bogovinjë dhe Gostivar.

Megjithatë, për shkak të vonesës në sjelljen e vendimit përfundimtar për mbajtje të rivotimeve dhe mendimit të KSHZ-së se informatat e votuesve nuk duhet të shpërndahen gjatë ditës së heshtjes parazgjedhore, nuk kishte kohë të mjaftueshme që të informohen drejt votuesit që duhej të hedhin fletëvotimin e tyre në disa vendvotime të veçanta. Një ulje prej 9% në daljen e votuesve në zgjedhje gjatë rivotimeve të 15 qershorit (krahasuar me daljen në zgjedhje gjatë 1 qershorit) mund t'i mvishet pjesërisht këtij faktori<sup>13</sup>.

### C. LISTAT E VOTUESVE

Përgjegjësinë mbi azhurnimin dhe mirëmbajtjen e listave të votuesve për momentin e mban Ministria e drejtësisë e cila bën azhurnimin e informatave të siguruara nga Ministria e punëve të brendshme dy herë në vit dhe të dhënave nga autoritet të tjera. Asnjëherë më parë nuk është bërë ndonjë kontroll i hollësishëm. Procesi i ndryshimit të vendbanimit dhe regjistrimi i detajeve është i gjatë, dhe dukshëm ka ndikuar që shumë njerëz të mos i informojnë autoritetet kur e ndryshojnë vendbanimin. Si rezultat i migracionit dhe emigracionit të brendshëm, disa rajone kanë më shumë emra në lista sesa banorë, që ngre çështjen e cilësisë së listave.

Për shkak të zgjedhjeve të parakohshme, periudha për kontrollim publik dhe rishikim të listave të votuesve u shkurtua për pesë ditë; u mbajt në mes 22 prill dhe 1 maj. U publikua njoftim në gazetat në gjuhën maqedonase, shqiptare dhe turke dhe në televizion. Gjithsej më pak se 40 000 mijë persona i kontrolluan të dhënat e tyre gjatë kësaj periudhe nëpërmjet zyrave lokale të Ministrisë së drejtësisë, nëpërmjet internetit ose nëpërmjet lidhjes telefonike. Kjo rezultoi në 715 ndryshime që iu bënë listave, përfshirë këtu edhe 354 persona të vdekur që u hoqën nga listat. Përveç kësaj, 67 191 votues të cilët e kishin identifikuar vetën si punëtorë të përkohshëm ose që jetojnë jashtë u lanë në lista në rast se kthehen për të votuar, por emrat e tyre u shënuan me asterisk.

Listat e votuesve përmbanin një numër votuesish prej 1 779 116, rritje prej 2 % nga 2006-ta. Listat mbetën të pandryshuara për rivotimet. Gjatë ditës së zgjedhjeve, votuesve potencial nuk u është lejuar të votojnë në 8 % të vendvotimeve që janë vizituar nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it sepse nuk kanë qenë në listat e votuesve. Numri i votuesve të refuzuar u rrit gjatë rivotimeve në 14 % të vendvotimeve të vëzhguara.

### D. REGJISTRIMI I LISTAVE TË KANDIDATËVE

Deri më 2 maj, 2 koalicione, 16 parti politike dhe 2 kandidatë të pavarur kishin parashtruar listat e kandidatëve për regjistrim në KSHZ. Pasi i shqyrtuan të gjitha dokumentet e parashtruara, më 4 maj, KSHZ-ja e refuzoi aplikimin e Partisë Punëtore Mbarë-Maqedonase, për shkak të dështimit në kompletimin e deklaratës për etnitet për disa nga kandidatët e vet. Edhe pse Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Nationale (VMRO-NP) dështoi në dorëzimin e certifikatës për regjistrim gjyqësor siç kërkohet me ligj, KSHZ-ja vendosi t'i regjistrojë ato meqenëse partia u gjet në të dhënat e gjykatës. Megjithatë, VMRO-NP më vonë dështoi në regjistrimin e llogarisë bankare për fushatën, për shkak të së cilës KSHZ-ja e tërhoqi listën e tyre të kandidatëve. Gjithsej 1 540 kandidatë në 18 lista u garuan

<sup>13</sup> Dalja e votueseve në zgjedhje në zgjedhjet parlamentare të 1qershorit ishte 58%. Dalja e votueseve në rivotimet e 15 qershorit në 187 vendvotime ishte afër 49 %, me rënie prej 9% prej 1 qershorit. Si përmbledhje, dalja e votuesve në të dy fazat e procesit zgjedhor ishte 57%.

në zgjedhjet parlamentare 2008, në gjashtë njësi zgjedhore. Më 9 maj, KSHZ-ja mbajti lotari të hapur për publikun për pozitën rendore në fletëvotime.

Lista e parashtruar nga Partia Social Demokratë e Maqedonisë (PSDM), parti e cila nuk ishte e përfaqësuar në Parlament, u problematizua gjatë regjistrimit të kandidatëve dhe periudhës së fushatës. Lista e tyre përmbante emra shumë të ngjashëm me ato të kandidatëve bartës të Lidhjes Social Demokratë të Maqedonisë (LSDM). LSDM parashtrroi ankesë me shkrim të KSHZ-ja. Ndonëse lista e kandidatëve të PSDM-së u pa si një orvatje për t'i habitur votuesit, KSHZ-ja mori përfundim se Kodi Zgjedhor nuk siguron bazë për të mos e pranuar listën. (Ankesa e LSDM-së në fjalë është përshkruar në pjesën Ankesat dhe Apelimet parazgjedhore).

KSHZ-ja gjithashtu aprovoi dy lista me kandidatë të cilët kishin qenë të dënuar me burg për më gjatë se gjashtë muaj<sup>14</sup>, në kundërvënje me Nenin 7 të Kodit Zgjedhor<sup>15</sup>. Kjo dispozitë u miratua kohëve të fundit nga Gjykata Kushtetuese<sup>16</sup>, e cila solli përfundim se efekti i dënimeve të tilla ndikojnë tek e drejta për të qenë kandidat, edhe gjatë dënimit edhe pas tij. Kryetari i Gjykatës e informoi MVZ-në të OSBE/ODIHR-it se kjo pasojë do të mbes deri sa efektet e dënimit skadojnë ose tërhiqen në bazë të ligjit<sup>17</sup>.

## VI. FUSHATA ZGJEDHORE

### A. KORNIZA LIGJORE PËR ZHVILLIMIN E FUSHATËS

Kodi Zgjedhor siguron periudhë zyrtare 20 ditore për zhvillim të fushatës. Nuk ekziston definicion për zhvillimin e fushatës në Kodin Zgjedhor, dhe as që përmenden në veçanti ndëshkime për dhunë gjatë fushatës. Kjo çështje u ngrit nga bashkëbisedues gjatë periudhës së para-fushatës kur një numër aktivistësh u vëzhguan duke promovuar partitë politike.

Kodi i rregullon në veçanti aktivitetet për fushatë në media, vendosjen e afisheve dhe billbordeve, dhe mbajtjen e tubimeve.

Në bazë të Kodit Zgjedhor, Kryetarët e komunave duhet të caktojnë hapësirë për vendosjen e materialit të fushatës. Këtë nuk e bënë të gjithë Kryetarët e komunave para zgjedhjeve dhe si rezultat, një numër i incidenteve u raportuan gjatë periudhës së hershme të fushatës (kryesisht në rajonet etnike shqiptare ku mbështetësit e BDI-së dhe PDSH-së disa herë e kontestuan me dhunë hapësirën e materialit të fushatës, flamujve dhe banderolave).

Gjatë gjithë periudhës së fushatës, vëzhguesit e MVZ-së të OSBE/ODIHR-it raportuan vetëm raste të izoluara të postërëve që janë grisur ose mbuluar.

<sup>14</sup> Njëri prej kandidatëve në fjalë ishte politikan i njohur i cili ishte dënuar me katër vite pasi që u shpall fajtor për përvetësim të fondeve komunale. Dënimi i tij më vonë u zvogëluar për 6 muaj me amnisti.

<sup>15</sup> Neni 7.2 i Kodit Zgjedhor thotë: "Secili qytetarë...ka të drejtë të zgjidhet për deputet...me kusht që atij/asaj... nuk i është dhënë vendim final i gjyqit për burgim me së paku 6 muaj."

<sup>16</sup> Vendimi Nr. U 125/2006-0-0 (21 nëntor 2007).

<sup>17</sup> Dispozitat riparuese të Kodi Penal (Nenet 103-105 kanë të bëjnë me skadimin e pasojave të dënimit për krime, si dhe shuarjen e tyre nëpërmjet metodave juridike ose mjeteve të tjera gjyqësore, duke përfshirë edhe kalimin e kohës, por asnjëra prej këtyre nuk ishte paraqitur gjatë këtyre dy rasteve.

## B. ZHVILLIMI I FUSHATËS ZGJEDHORE

Periudha zyrtare e fushatës filloi më 11 maj dhe mbaroi në mesnatë më 30 maj, duke pasuar 24 orë të periudhës së heshtjes parazgjedhore. Dy koalicionet kryesore maqedonase – VMRO-DPMNE dhe koalicioni "*Dielli*" i LSDM-së – si dhe dy partitë kryesore të shqiptarëve – PDSH dhe BDI – organizuan fushatë aktive dhe të dukshme në të shumtën e rajoneve, duke përdorur afishe, billborde dhe reklama të paguara. Vëzhguesit e OSBE/ODIHR-it vërejtën fushatë pasive dhe pak të dukshme nga 14 kandidatët tjerë në lista. Vetëm edhe një parti tjetër, Partia për Ardhmëri Evropianë (PAE) kishte reklama të paguara televizive.

Një numër i madh i tubimeve u mbajtën nga 4 listat kryesore të kandidatëve gjatë gjithë fushatës, me dhjetëra mijëra mbështetës që morën pjesë në tubimet e mëdha. Vëzhguesit e MVZ-së të OSBE/ODIHR-it dëshmuuan rreth 40 tubime dhe i vlerësuan ato si përgjithësisht mirë të organizuar dhe të drejtuar. Në pjesën më të madhe, nuk pati konfrontime të drejtpërdrejta gjatë tubimeve. Megjithatë, pas një tubimi të madh të BDI-së në Tëtovë, më 29 maj, policia arrestoi tre aktivistë të BDI-së dhe me këtë nxiti mbështetësit e BDI-së të bllokojnë autostradën Tëtovë-Shkup dhe të marrin peng një polic. Situata u zhblokua me lirim të tre aktivistëve të BDI-së nga ana e policisë.

Të gjitha palët pjesëmarrëse në zgjedhje nënshkruan Kodeksin e mirësjelljes dhe u përbetuan se do të "promovojnë zgjedhje të lira dhe të drejta dhe klimë demokratike të tolerancës" dhe se do të "ndëshkojnë publikisht dhunën dhe frikësimin"<sup>18</sup>. Megjithatë, toni i fushatës u bë gjithnjë e më i ashpër gjatë periudhës së fushatës, me zmadhimin e nivelit të sulmeve personale dhe akuzimeve. Gara në mes të dy partive udhëheqëse të taborit etnik shqiptar përfshinë retorikë të fortë, e cila mund të ketë nxitur edhe aktet e dhunshme të cilat ndodhën.

## C. AMBIENTI I SIGURISË

Ambienti i sigurisë gjatë periudhës së fushatës ndryshonte dukshëm në mes rajoneve kryesisht me shqiptar etnik dhe pjesës tjetër të vendit. Përderisa vetëm disa incidente u raportuan në pjesën më të madhe të vendit, një numër i konsiderueshëm i akteve të dhunës dhe frikësimit u raportuan në rajonet kryesisht me shqiptar etnik. Policia shpesh nuk u përgjigjej incidenteve të tilla ose nuk orvatej të parandalojë incidente të mëtejshme, duke krijuar atmosferë mosndëshkimi.

Në bazë të MPB-së, gjatë periudhës 11 dhe 26 maj, kanë marrë informata për 14 sulme të selive partiake dhe dy zyrave të degëve komunale të partive politike<sup>19</sup>. Në atë kohë, nuk ishin bërë asnjë lloj hetimesh në lidhje me këto incidente. Megjithatë, u ndërmorën katër hetime në lidhje me incidentet e sigurisë. Në një incident të profilit të lartë, më 12 maj, konvoi i kryetarit të BDI-së, Ali Ahmetit, u sulmua me armë; fajtorët u paraburgosën dhe u dënuan.

Gjatë periudhës deri në zgjedhje, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it mori një numër të madh të raporteve nga partitë politike dhe qytetarë lokal për incidente të tjera të supozuara. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it morr gjithsej 19 raporte për sulme ndaj zyrave të BDI-së, pesë kidnapime të mbështetësve të BDI-së dhe dy sulme ndaj shtëpive të mbështetësve të BDI-së, një sulm ndaj zyrës së PDSH-së dhe 6 incidente me të shtëna armësh. Ato që u raportuan nga BDI-ja doli se jo gjithëherë kanë qenë të paraqitura tek autoritetet.

<sup>18</sup> Kodeksi për mirësjellje për zgjedhje parlamentare të lira dhe të drejta, nënshkruar më 8 maj 2008.

<sup>19</sup> BDI-ja pësoi 10 sulme, PDSH-ja 2 dhe VMRO-DPMNE-ja dhe LSDM-ja nga 1.

Përveç kësaj, kishte raporte të shumta për makina të cilat kalojnë nëpër fshatra vonë gjatë natës me burra të armatosur, si dhe thashetheme se shqiptarë nga Kosova ilegalisht e kalojnë kufirin me qëllim që të krijojnë probleme gjatë ditës së zgjedhjeve. Edhe pse këto supozime nuk u vërtetuan, ato ndikuan në rritjen e tensionit.

Në bazë të një numri të madh të bashkëbiseduesve të MVZ-së të OSBE/ODIHR-it, përfshirë këtu edhe zyrtarë qeveritar, problemi i sigurisë në rajonet kryesisht me shqiptar etnik rrjedh nga politicizimi i niveleve të larta të policisë. Bashkëbiseduesit, edhe ato të MPB-së, në veçanti e përmendnin Zëvendës Ministrin e punëve të brendshme Refet Elmazin (i cili ishte shkarkuar, por nuk u zëvendësua dhe kështu vazhdoi të veprojë në funksionin që pati) dhe Shefi i policisë rajonale Faik Dervishi për zbatim selektiv të ligjit. Të dy njihen si aktivistë të PDSH-së.

#### **D. ÇËSHTJE SHTËTËRORE DHE PARTIAKE**

Përdorimi i burimeve qeveritare për aktivitete partiake luajti rol të rëndësishëm në debatet publike, posaçërisht gjatë fillimit të fushatës. Fushatat e dukshme, që reklamnin suksesin e politikave të qeverisë përpara se të fillojë fushata zgjedhore, nxitën kritika publike; pas ankesave nga palët e përfshira në zgjedhje dhe bashkësia ndërkombëtare këto fushata u ndërpre në Qeveria.

Përderisa reklamat e paguara për sukseset e Qeverisë u ndërpre, programet e Qeverisë të cilët ofronin kontrollë mjekësore falas nëpër vende publike, punësimi i stafit punës dhe hapja e Qendrave shëndetësore nëpër fshatra vazhduan gjatë gjithë periudhës së fushatës. Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit e mori këtë praktikë si jokonsistentë me Ligjin për parandalim të korrupsionit, por Ministri i shëndetësisë, kandidatë dhe udhëheqës i fushatës së PDSH-së, pohoi se këto aktivitete ishin pjesë e planit vjetor të Qeverisë dhe prandaj u lejuan. Kjo çështje u problematizua nga ana e Kryetarit të Komisionit për parandalim të korrupsionit.

Një tjetër çështje konfliktuoze doli nga përgjigjja e policisë, gjoja të partizuar, ndaj incidenteve që kishin lidhje me zgjedhjet. Shembujt përfshijnë edhe paraburgimin e një personi privat i cili incizonte tubimin e koalicionit të VMRO-DPMNE-së në Shtip më 20 maj, dhe një deklaratë të Ministres për punë të brendshme (dhe bartëses së listës nga VMRO-DPMNE-ja në njësinë zgjedhore 6) se Ministria do të ngrejë aktpadi ndaj Kryetares së LSDM-së për shpifje në lidhje me deklaratat e saj për mos efikasitet të forcave policore.

#### **E. FINANCIMI I FUSHATËS**

Organizatorët e fushatës duhet të hapin llogari të veçantë për fushatën, nëpërmjet të së cilës duhet të kalojnë të gjitha donacionet dhe harxhimet me qëllim që të regjistrohen për zgjedhjet<sup>20</sup>. Ekziston kufi i harxhimeve të përgjithshme për një fushatë prej 60 MKD (rreth 1 euro) për një votë të regjistruar<sup>21</sup>. Organizatorët e fushatës duhet të dorëzojnë raport financiar të KSHZ-ja, Zyra shtetërore për revizion dhe Parlamenti, brenda 30 ditëve pas verifikimit të mandatit të Parlamentit të ri. Megjithatë, nuk kërkohet vërtetim i të dhënave ose krahasime me nivelin e harxhimit që është vërejtur. Në bazë të disa informatave jozyrtare, harxhimet e

---

<sup>20</sup> Kodi Zgjedhor, Neni 71.

<sup>21</sup> *Ibid.*, Neni 84.

mbartësve kryesorë të fushatës i kanë tejkaluar kufijtë; në praktikë, nuk ekziston kontroll efektiv në financimin e fushatës.

Reformat për financim të fushatës janë identifikuar si parakusht për progres në procesin për stabilizim dhe anëtarësim në BE. Në fillim të vitit, Ministria e drejtësisë zhvilloi propozim-amendamente shtesë për Kodin Zgjedhor në lidhje me këtë çështje, por ato ende nuk janë dorëzuar në Parlament. Amendamentet, inter alia: i zbatojnë në mënyrë eksplicitë restriksionet dhe kufizimet që përmbahen në Ligjin për financim të partive politike dhe financim të fushatës (siç janë lartësia e donacioneve individuale dhe vlerësimi i kontributeve me të mira materiale); kërkohet nga pjesëmarrësit në fushatë të bëjnë regjistrimin e donacioneve/harxhimeve; ta dyfishojnë kufirin e përgjithshëm të harxhimeve; të kërkojnë raport në mes të fushatës; në fund të fushatës dhe pas zgjedhjeve; të kërkohet që të dhënat financiare për reklamat e fushatës të dërgohen nga të gjitha mediat; dhe të sigurohen kopje të raporteve financiare që të dorëzohen tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit.

## VII. MEDIAT

### A. AMBIENTI I MEDIAVE

Ekziston një ambient i llojlojshëm i mediave mbarë vendit i cili përfshin 54 stacione televizive, 67 radio stacione dhe publikime të shumta të shtypit<sup>22</sup>. Televizioni konsiderohet si burim kryesor i informatave me tre stacione televizive publike<sup>23</sup> dhe pesë private<sup>24</sup> të cilët kanë mbulesë mbarë vendit. Edhe pse mediat janë të shumëllojshme, pronarët e tyre shpesh luajnë rol vendimmarrës në përcaktimin e politikës redaktuese, në disa raste edhe i përdorin mediat për mbrojtjen e interesave të veta politike dhe ekonomike.

Kanali Televiziv (MRTV) u krijua si rezultat i transformimit të mediave shtetërore në vitin 1993. MRTV-ja duhet të financohet nga taksat për radiodifuzion, por procedurat për mbledhjen e këtyre taksave asnjëherë nuk u rregulluan, dhe për atë shkak varet prej fondeve shtetërore. Vendimet për financimin shtetëror të MRTV-së bëhen në mënyrë sporadike, që e nënvlerëson profesionalizmin dhe pavarësinë e saj. Të punësuarit në Radiodifuzionin publik filluan grevë më 5 qershor, duke kërkuar pagesën e rrogave të cilat nuk i kishin marrë për pesë muaj.

### B. KORNIZA LIGJORE

Mbulimi i fushatës zgjedhore nëpër media është e rregulluar me Kodin Zgjedhor dhe ligjin për radiodifuzion. Kodi zgjedhor i detyron mediat të sigurojnë kushte të barabarta dhe qasje të barabartë në prezantimin e programeve zgjedhore të të gjithë kandidatëve<sup>25</sup>. Gjithashtu e detyron Parlamentin të aprovojë instruksione për mbulimin e zgjedhjeve në media gjatë fushatës zgjedhore. Megjithatë, Parlamenti u shpërnda në 18 prill, përpara se t'i sillte rregullat për mbulim të zgjedhjeve nga ana e transmetuesve. Këshilli për radiodifuzion, me iniciativë të vet, solli instruksione të tilla më 18 prill. Megjithëse, ato nuk kishin fuqi ligjore. Ligji për veprimtari radiodifuzive e autorizon Këshillin për radiodifuzion të paralajmërojë dhe t'i

<sup>22</sup> Këshilli për radiodifuzion, Shkup.

<sup>23</sup> MTV-1, MTV-2, Kanali Parlamentar (MRT).

<sup>24</sup> AI, Kanal 5, Sitel, Alsat-M, Telma.

<sup>25</sup> Kodi Zgjedhor, Neni 75.

ndalojnë përkohësisht reklamat komerciale në media si një lloj sanksionimi për keqpërdorim të rregullave të përgjithshme për radiodifuzion.

Përputhshmëria e mediave me ligjin mbikëqyret nga Këshilli për radiodifuzion, organi leje dhënës. Ky organ përbëhet nga 9 anëtarë të propozuar dhe aprovuar nga parlamenti. Deri tek zgjedhjet, mandati i tre anëtarëve kaloi, dhe Parlamenti nuk kishte emëruar anëtarë të ri, duke shkaktuar Këshillin të funksionojë në kapacitet të kufizuar. Ligji për veprimtari radiodifuzive u lejon stacioneve televizive dhe radio stacioneve të ndajnë deri 12 minuta në orë për çdo lloj të reklamave komerciale gjatë periudhës para fushatës. Gjatë fushatës zyrtare, Këshilli për radiodifuzion u lejoi mediave të ndajnë edhe 12 minuta plotësuese në orë për reklama të fushatës, përderisa asnjë reklamë politike nuk lëshohet gjatë 12 minutave të rregullta për reklamat komerciale.

Të gjitha mediat për radiodifuzion publikuan listë të çmimeve për reklamat politike. Megjithatë, partitë politike dhe koalicionet e tyre morën edhe zbritje, të cilat nuk u bënë publike, dhe madhësia e të cilave u vendos në baza individuale (u raportua se ka lëvizur në mes 10 deri në 90 % nga çmimi i publikuar). Në praktikë kjo krijoi kushte jo të barabarta për qasje tek koha e paguar për reklama për partitë politike dhe koalicionet e tyre. Edhe pse kërkohet që të gjitha partitë politike të kenë trajtim të barabartë nga mediat në prezantimin e programeve zgjedhore të tyre, nuk ekziston kërkesë eksplicite së të gjithë kandidatët, koalicionet dhe partitë duhet të marrin çmim të njëjtë për periudhën e njëjtë kohore dhe ndarje të shikuesve kur blejnë kohë për reklamim.

Ndalesa për denoncim dhe shpifje ende përfshihen në Kodin Penal. Përderisa ndryshimet e Kodit në vitin 2006 e ndryshuan dënimin me burg në dënim me të holla, gazetarët gjatë punës së tyre profesionale ende mund t'u nënshtrohen kallëzimeve penale.

### C. MBULIMI I FUSHATËS

Ashtu siç kërkohet me ligj, transmetuesit publik ndanë kohë transmetimi për të gjithë parashtruesit e listave të kandidatëve. Shumica e partive politike dhe koalicioneve e shfrytëzuan këtë mundësi t'i prezantojnë pikëpamjet e tyre dhe platformat zgjedhore. Kohë transmetimi pa pagesë ishte në dispozicion vetëm në gjuhën maqedonase në MTV-1, dhe njëri nga kandidatët i cili refuzoi të flasë maqedonisht prandaj nuk iu transmetua video klipi.

Që të dy kanalet publike MTV-1 dhe MTV-2 emituan programe speciale të cilët u reflektuan në ngjarje të ndryshme të pjesëmarrësve në zgjedhje gjatë fushatës. Transmetuesi publik gjithashtu organizoi gjithsej 14 debate në gjuhën shqipe dhe maqedonase<sup>26</sup>. Asnjëri nga kryetarët e dy koalicioneve më të mëdha, as edhe kryetarët e partive më të mëdha të shqiptarëve etnik nuk morën pjesë në asnjërin prej debateve. Kjo ndodhi edhe përkundër thirrjeve për debat që ia bënte kryetarja e koalicionit "Dielli" Kryeministrit dhe Kryetarit të VMRO-DPMNE-së.

Këshilli për radiodifuzion është i obliguar të vëzhgojë të gjitha mediat që transmetojnë program gjatë periudhës zyrtare të fushatës. Ky organ filloi t'i vëzhgojë mediat me fillimin e zyrtar të fushatës, megjithëse Këshilli nuk i përfshiu radio stacionet rajonale në vëzhgimin e mediave, për shkak të situatës së tyre të dobët financiare.

<sup>26</sup> MTV-1 organizoi 4 debate televizive, në mes partive politike dhe koalicioneve të cilët garonin në 5 ose 6 njësi zgjedhore. MTV-2 i cili transmeton në gjuhën shqipe, organizoi debate televizive në mes përfaqësuesve të partive etnike shqiptare.

Në përgjithësi, gjatë periudhës së fushatës, Këshilli për radiodifuzion lëshoi 45 paralajmërime dhe rreth 132 rekomandime<sup>27</sup> të jo detyrueshme për 7 stacione televizive nacionale dhe 29 rajonale. Veçanërisht, MTV-2 mori 2 paralajmërime për “mbulim predominant të PDSH-së gjatë programeve informative<sup>28</sup>”. MTV-1 mori një paralajmërim për mbulim të pa balancuar, përderisa radio shërbimi publik dhe Televizioni *Alsat-M* morën rekomandime për të korigjuar mbulimin e pa balancuar. Veprimet e Këshillit, sidoqoftë, nuk patën ndonjë efekt korigjues të dukshëm tek transmetuesit.

#### D. VËZHGIMI I MEDIAVE NGA MVZ OSBE/ ODIHR

MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it bëri vëzhgimin e mediave duke përdorur analizat kualitative dhe kuantitative të gjashtë kanaleve<sup>29</sup> televizive dhe gjashtë gazetave<sup>30</sup>. Vëzhgimi filloi më 30 prill dhe përfshiu edhe periudhën e fushatës zyrtare prej 20 ditëve, si dhe 24 orët e heshtjes parazgjedhore. Në përgjithësi, mediat u siguruan partive politike kryesore dhe koalicioneve mundësinë e prezantimit të platformave dhe mendimeve të tyre gjatë pjesës së parë të lajmeve. Megjithatë, mungesa e raportimit analitik e kufizoi rolin e mediave në informimin e votuesve për garën zgjedhore.

Prej 30 e deri në fillimin e periudhës së fushatës zyrtare, MTV-1 (e cila transmeton në gjuhën maqedonase) ndau rreth 26% të mbulimit pozitiv të koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja, përderisa koalicioni *Dielli* mori 20 % të mbulimit neutral. Kjo nuk ndryshoi me fillimin zyrtar të fushatës; koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE mori 24 % të mbulimit pozitiv, përderisa koalicioni *Dielli* mori 19 % të mbulimit, më shumë neutral por me ton pozitiv. Përveç kësaj, MTV-1 përkushtoi një sasi të konsiderueshme të mbulimit të aktiviteteve të autoriteteve. Të dyja partitë shqiptare – PDSH dhe BDI u trajtuan barabartë dhe secila prej tyre mori rreth 8% të mbulimit. MTV-1 bëri një program zgjedhor të veçantë i cili ishte i balancuar në mbulimin e dy koalicioneve kryesore maqedonase; secili prej tyre mori rreth 34% të mbulimit pozitiv.

Kanali publik MTV-2, i cili transmeton në gjuhën shqipe, ishte më i njëanshëm në mbulim dhe qartë ishte në favor të PDSH-së. Përpara se të filloi fushata zgjedhore, kanali ndau 21% mbulim pozitiv të aktiviteteve të PDSH-së, përderisa BDI-ja mori 9%, më tepër me ton negativ. Gjatë periudhës së fushatës zyrtare, favorizimi i PDSH-së u rrit. MTV-2 ndau 42 % të mbulimit të aktiviteteve të PDSH-së, më shumë me ton pozitiv, përderisa BDI-ja mori rreth 19% më shumë mbulim negativ dhe neutral. Trend i ngjashëm u vërejt në programet speciale zgjedhore të tij.

Ekzistonin dallime të dukshme në mbulimin e fushatës nga ana e transmetuesve privat të cilët u vëzhguan nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it. Gjatë fushatës zyrtare, A1 dhe Kanal 5 ofruan për shikuesit e tyre mbulim të balancuar të partive politike më të mëdha. TV Sitel, megjithatë, ishte qartë i anshëm në favor të koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja, që mori rreth 34 % të mbulimit pozitiv. Në të kundërtën, koalicioni *Dielli* mori rreth 20% të mbulimit negativ dhe disa herë neutral. TV Alsat-M u fokusua më shumë në aktivitetet e partive etnike

<sup>27</sup> Meqë Parlamenti nuk i solli instruksionet për mbulim të fushatës nga mediat gjatë fushatës zyrtare, shkëlqet jashtë asaj, që janë rregulluar me ligjin e përgjithshëm për veprimtari radiodifuzive, nuk kishin fuqi legale, dhe prandaj merreshin si rekomandime jo-detyruese.

<sup>28</sup> Njëra u lëshua para dhe tjetra pas fillimit zyrtar të fushatës.

<sup>29</sup> MTV-1, MTV-2, A1, Kanal 5, Sitel, Alsat-M.

<sup>30</sup> *Dnevnik, Utrinski Vesnik, Vreme, Vecer, Koha, Lajm*



shqiptare, duke favorizuar pak më shumë BDI-në. Gjatë periudhës së fushatës zyrtare, BDI-ja mori 27 %, kurse PDSH-ja 25%.

Mediat e shkruara që u vëzhguan nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it prezantuan një sërë pikëpamjesh. Përderisa *Vreme*, *Dnevnik dhe Utrinski Vesnik*, siguronin mbulim që favorizonte koalicionin *Dielli*, *Vecer-i* dukshëm favorizonte koalicionin e udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja, dhe e kritikonte ashpër koalicionin *Dielli*. Një trend i ngjashëm u vëzhgua tek mediat në gjuhën shqipe, *Koha* që favorizonte PDSH-në dhe *Lajm* favorizonte BDI-në.

## VIII. ANKESAT DHE APELIMET PARAZGJEDHORE

Kandidatët në zgjedhje kanë pasur vetëm qasje të kufizuar të këshillat juridik efikas dhe mundësi për t'u ankuar për shkeljet e supozuara para ditës së zgjedhjeve, pjesërisht për shkak të mospërputhjeve të legjislacionit, por edhe për shkak të një interpretimi të ngushtë të kompetencave të organeve ankuese dhe të apelit. Gjykatësit e gjykatave themelore dhe të apelit mbetën kryesisht të panjohur me rolin e tyre për sa i përket shkeljeve gjatë fushatës, ndërsa Gjykata Supreme i përkufizoi apelet nga vendimet e administratës zgjedhore deri të ato të cilat në mënyrë eksplicite ishin lejuar në Kodin Zgjedhor.

Sa i përket shkeljeve të fushatave zgjedhore, mjetet për mbrojtje ligjore u duken të kufizuara dhe jo tërësisht të sqaruara në ligjin aktual. Dispozitat e vetme relevante të Kodit Zgjedhor të cilat u mundësuan kandidatëve, të drejtat e të cilëve ishin nëpërkëmbur - “duke e dhunuar dhe penguar fushatën e oponentëve” - u lejuan atyre të kërkojnë korrigjim në gjykatën themelore përkatëse (me të drejtë apelimi në Gjykatën e Apelit).<sup>31</sup> Lloji i padisë që mund të parashtrohet në baze të kësaj dispozite është i papërcaktuar, siç janë edhe kategoritë e të pandehurve të mundshëm (përfshirë kandidatët rivalë ose organizatorët e fushatave, persona privat, madje ndoshta edhe zyrtarë komunal dhe shtetëror). Megjithatë fjalët “parandalimi dhe pengimi i ... fushatës” janë të njëjta me ato të cilësuar si kundërvajtje<sup>32</sup> në Kodin Zgjedhor, neni kryesor nuk flet për atë nëse forma e padisë, për nga natyra e saj, do të ishte civile apo penale.

Disa gjykata themelore dhe të apelit, me të cilat kontaktoi MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it, kishin qasje të ndryshme për rolin e tyre në procesin e ankesave dhe apeliemeve. Disa prej tyre mohuan të kenë çfarëdo lloj juridiksioni mbi rastet [gjyqësore] të zgjedhjeve; të tjerë treguan se mund të fillonin procedura të kundërvajtjes (që kishin si përfundim gjoba, e madje edhe kompensimin e viktimave); megjithatë disa të tjerë ishin të hapur të merrnin në konsideratë padi civile me qellim që të shpallnin se ishin shkelur të drejtat e fushatës. Megjithatë, nuk u soll asnjë aktakuzë ndaj shkeljeve gjatë fushatës.

Shtrirja e apeliemeve gjyqësore, në dispozicion të garuesve në zgjedhje, u zvogëluar për dallim nga zgjedhjet e mëparshme. Përderisa Gjykata Supreme kishte më parë juridiksionin e përgjithshëm që të vendos për apelet administrative,<sup>33</sup> ky juridiksion i është transferuar Gjykatës Administrative. Në mungesë të juridiksionit të përgjithshëm administrativ, Gjykata Supreme ushtroi kompetencat e saja vetëm për apelet, të cilat në mënyrë specifike janë paraparë në Kodin Zgjedhor. Për shembull, në rast të një ankesë nga koalicioni “Dielli”, i

<sup>31</sup> Kodi Zgjedhor, Neni 73.

<sup>32</sup> Kodi Zgjedhor, Neni 181.

<sup>33</sup> Ligji mbi gjykatat (1995) [zëvendësuar në vitin 2006], Neni 34.3.

udhëhequr nga LSDM-ja kundër regjistrimit të listës së kandidatëve të PSDM-së (e cila përfshinte udhëheqës listë me emra shumë të ngjashëm me ata të udhëheqësve të listës së LSDM-se), Gjykata Supreme e hodhi poshtë mundësinë e apelimit mbi bazë të mungesës së të drejtës eksplicitë për një ankesë të tillë në Kodin Zgjedhor.

Pas shfaqjes së informacioneve në shtyp se disa nga kandidatët e PSDM-së nuk kishin dhënë pëlqimin e tyre për t'u kandiduar, Prokurori Publik i Shkupit kërkoi nga policia të marrë informacion nga ata. Ato të dhëna nuk u morën para ditës së zgjedhjeve. Për atë shkak, Prokurori i Shkupit erdhi në përfundim se kandidatët në fjale ishin pajtuar për kandidaturat e tyre.

## IX. PJESËMARRJA E GRAVE

Gratë luajtën një rolë të rëndësishëm në këto zgjedhje, edhe si kandidatë edhe në administrimin zgjedhor. Në pajtim me Kodin Zgjedhor, çdo i treti vend në listën e kandidatëve duhej medoemos t'i takonte një gruaje. Partitë politike e përmbushen këtë kërkesë, ndërsa nga gjithsejtë 1540 kandidatë, 35% (ose 462 kandidatë) ishin gra. Në zgjedhjet e parakohshme të vitit 2008, 37 gra u zgjodhën në Parlament, prej të cilave 7 ishin shqiptare etnike dhe një vllahë. Kjo paraqet 30.8% të gjithsejtë 120 deputetëve në kuvend. Me këtë u arrit synimi për 30% të pjesëmarrjes së gjinisë më pak të përfaqësuar në Parlament, një synim ky i caktuar nga Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore, në vitin 1999.

Dy nga shtatë anëtarët e KSHZ-së ishin gra, por gratë ishin proporcionalisht më të përfaqësuar në të gjitha nivelet me të ultët të administratës zgjedhore. Për sa i përket KKZ-ve, përfaqësimi i grave ndryshonte nga 30% në disa KKZ deri në 70% në disa të tjera. Rreth 44% e të gjitha KKZ-ve u kryesuan nga femra në 50% të këshillave zgjedhor kishin një grua për zëvendës kryetare; në 9% të të gjithë këshillave zgjedhore (267) nuk kishte anëtare femra.

Votimi familjar ishte njëra nga parregullsitë e vërejtura në shkallë të gjere nga vëzhguesit në ditën e zgjedhjeve. Me votim familjar kryesisht nënkuptohet kur një burrë i familjes i drejton gratë gjatë votimit ose madje edhe voton në vend të tyre. Kjo dukuri vazhdon ta dobësojë të drejtën e gruas për të hedhur votën e saj në fshehtësi dhe ka si përfundim t'ia heqë asaj këtë të drejtë. Te votimi familjar u vërejt një dallim i dukshëm etnik, ku vëzhguesit raportuan për votim familjar në 34% të vendvotimeve të vëzhguara në zonat e banuara kryesisht nga shqiptar etnik dhe në 12% të zonave tjera. Në shumë raste kryetarët e këshillave zgjedhor bënë përpjekje të pakta që t'i pengojnë burrat të hyjnë në kabinat e votimit bashke me anëtarët femra të familjeve të tyre. Gjithashtu u vu re shpeshherë se reagimi ndaj problemeve serioze në lidhje me votimin familjar u trajtua me shpërfillje, meqenëse praktika e tillë u konsiderua si 'tradicionale' te shumë njerëz në bashkësinë etnike shqiptare. Mungesa e trajnimit dhe frikësimi u përmenden para vëzhguesve të OSBE/ODIHR-it si arsye për votimin familjar. Një program i paracaktuar për të edukuar organin zgjedhor mbi këtë temë nuk u zbatua plotësisht para zgjedhjeve.

Çështjet gjinore nuk u paraqitën në asnjë nga manifestet partiake ose programet zgjedhore të kandidatëve. Asnjë nga kandidatët nuk u dërgojë mesazhe specifike lidhur me votimin femrave votuese. Mesazhet për edukimin e votuesit, të transmetuar para zgjedhjeve kishin për qëllim pjesëmarrjen e përgjithshme të votuesit dhe nuk adresonin problematiken e votimit familjar.

Reportazhet e kandidatëve në media nuk reflektuan baraspeshën gjinore të listave të kandidatëve. Në lajmet kryesore, reportazhet për kandidatët femra silleshin nga 6% në televizionin publik MTV-2, që transmeton në gjuhen shqipe, deri në 31% të reportazhit në televizionin privat *Kanal 5*, i cili transmeton në gjuhen maqedonase.

## X. PJESËMARRJA E BASHKËSIVE ETNIKE

Procesi zgjedhor dhe ai më i gjënë politik ka për tendencë të fokusohet në çështjet që kanë të bëjnë me dy bashkësitë me të mëdha etnike - maqedonase dhe shqiptare - si dhe marrëdhëniet mes tyre. Megjithatë, anëtarët e bashkësive tjera po përpiqen që gjithashtu të luajnë një rol me ndikim, duken u orvatur ta zgjerojnë dialogun shtetëror përtej debatit dy-etnik. Bashkësitë tjera etnike të vendit, të pranuar zyrtarisht - turqit, serbet, romet, vllahët dhe boshnjaket - të cilët përbejnë mbi 10% të popullsisë së përgjithshme, ishin të përfaqësuar në parlamentin e mëparshëm, por, megjithatë kanë pasur vështirësi që të luajnë një rol më të rëndësishëm në politikën e vendit.

Gjatë këtyre zgjedhjeve, bashkësitë etnike u përfaqësuan nga disa parti politike në baza etnike, shumica e të cilave iu bashkëngjitën koalicionit parazgjedhor të VMRO-DPMNE-se dhe me një rast koalicionit *Dielli* të prire nga LSDM-ja. Vlen të përmendet se koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja përfshiu pesë parti politike të romeve, duke i bashkuar, për herë të parë, të gjitha partitë politike përkatëse të romeve. Përveç kësaj, një numër modest prej gjashtë kandidatësh, të cilët i takojnë bashkësive tjera etnike, ishin në vetë listat e partive kryesore. VMRO-DPMNE-ja, në bashkëpunim me disa nga partitë me baza etnike, arriti t'i tërheqë këto parti *inter alia*, duke arritur marrëveshje parazgjedhore për disa çështje të rëndësishme për ta.<sup>34</sup> Kjo do të paraqesë sfida, në mandatin e ardhshëm, si për Qeverinë ashtu edhe për Parlamentin.

Gjithsejtë, përveç 29 kandidatëve shqiptarë etnikë, edhe 9 kandidatë që përfaqësojnë bashkësitë turke, serbe, rome, vllahe dhe boshnjake fituan vende në parlamentin e ri.

## XI. VËZHguesIT VENDORË

Në ditën e zgjedhjeve, më 1 qershor, pati pjesëmarrje të konsiderueshme të vëzhguesve vendor të zgjedhjeve, me njëmbëdhjetë grupe vëzhguesish vendor jopartiak që numëronin gjithsejtë 5, 592 vëzhgues. Grupin më të madh të vëzhguesve e përbënte MOST me 4,100 vëzhgues të regjistruar. Vëzhguesit vendorë ishin prezentë në 70% të vendotimeve të vëzhguara, në 65% prej të cilëve ishte prezent MOST-i. Analiza statistike e MVE -së të OSBE/ODIHR-it tregon një ndikim pozitiv të vëzhguesve vendor mbi cilësinë e procesit zgjedhor. Në rast se një vëzhgues i MOST-it ishte i pranishëm në një vendvotim, vlerësimi i përgjithshëm ishte më pozitiv (6% të raporteve negative) se sa kur përfaqësuesi i MOST-it nuk ishte i pranishëm (11% të raporteve negative). Ky ndikim pozitiv u shënuar veçanërisht në zonat me shumicë shqiptare.

MOST lëshoi tri kumtesa për shtyp në ditën e zgjedhjeve dhe raportoi për 80 incidente. Ata gjithashtu njoftuan se kishin vëzhguar edhe 55 incidente tjera të cilat nuk kishin arritur t'i

<sup>34</sup> Themelimi i mundshëm i një Agjencioni për të drejtat e pakicave, sjellja e një ligji mbi bashkësitë dhe ndryshime të Kodit Zgjedhor që do të sigurojë vende të garantuara për pakicat më të vogla në vend.

publikojnë për shkak të nevojës së mbrojtjes së vëzhguesve të tyre. Për shkak të brengosjeve mbi sigurinë në ditën e zgjedhjeve, MOST tërhoqi 86 vëzhgues nga Tetova dhe Gostivari si dhe nga pjesa më e madhe e Shkupit. Përveç kësaj, 11 vëzhgues të tyre u përzunë me force nga vendvotimet në zonën e Tetovës.

MOST poashtu administroi një tabelë paralele të votimit (PVT) në mbrëmjen e zgjedhjeve, duke mbuluar 30% të të gjitha vendvotimeve, për të verifikuar saktësinë e përlogaritjes së rezultateve. Megjithatë përgjithësisht të sakta, niveli i lartë i parregullsive dhe për pasojë anulimi i rezultateve dëmtuan saktësinë e PVT-së për zonat zgjedhore 1, 2 dhe 6.

MOST ishte i vetmi grup vendor për vëzhgim, i regjistruar për të vëzhguar përsëritjen e zgjedhjeve më 15 qershor, që u mbajt në 187 vendvotime. Për t'i adresuar shqetësimet e mundshme mbi sigurinë, MOST dërgoi vëzhgues në grupe prej dy individëve, që ishte ndryshim nga zgjedhjet më 1 qershor kur ishin vendosur vëzhgues individual. Numri më i vogël i vendvotimeve i lejoi MOST-it të ketë ekipe të stacionuara në 130 vendvotime dhe në 15 KKZ. Gjatë përsëritjes së zgjedhjeve, vëzhguesit e OSBE/ODIHR-it vërejtën se vëzhguesit e MOST-it ishin të pranishëm në 86% të vendvotimeve.

## **XII. VËZHGIMI NË DITËN E ZGJEDHJEVE**

### **A. GJENDJA E SIGURISË**

Dita e zgjedhjeve më 1 qershor u njolloso nga incidente të dhunshme dhe frikësim në zonat me shumicë shqiptare.<sup>35</sup> Ndonëse gjendja e sigurisë në këto zona u stabilizua gjatë tërë rrjedhës së ditës, incidentet e mëngjesit të hershem lanë një person të plagosur për vdekje dhe të tjerë të plagosur.

Fatkeqësia ndodhi gjatë një incidenti në fshatin Haraçin, shumë afër kryeqytetit - Shkupit, ku policia u përfshi në një incident të armatosur me kriminelët. MVE-ja e OSBE/ODIHR-it pranoi raporte se grupe kriminale kishin hyrë në Haraçin një natë përpara ditës së zgjedhjeve. Deri në orët e mëngjesit, njerëz të armatosur u vërejtën duke shëtitur haptas nëpër rrugë, ndërsa hyrja e Haraçinës ishte bllokuar. Sipas MPB-së, individë të armatosur me armë të rënda hapën zjarr mitralozi dhe armësh automatike mbi policinë, e cila hyri në fshat. Policia iu përgjigj me zjarr dhe për pasojë një person u plagos për vdekje, dy të tjerë u plagosën, kurse njëmbëdhjetë pjesëmarrës të dyshuar u arrestuan nga policia.

Edhe pse nuk pati aksidente të tjera të rënda, u be e ditur edhe për shumë raste të tjera të dhunës dhe të frikësimit në ditën e zgjedhjeve. Vëzhguesit e Misionit Ndërkombëtar të Vëzhgimit të Zgjedhjeve (IEOM) raportuan 19 raste të frikësimit, nga të cilat 14 raste ndodhen në zonat me shumicë shqiptare. Shumica prej tyre ishin kundër anëtareve të këshillave zgjedhor, si në Berovë (Vendvotimi nr. 2890) ku u sulmua kryetari i këshillit zgjedhor. Tensionim dhe rrëmujë u vu re në 3% të të gjitha vëzhgimeve - në 7% të zonave etnike shqiptare dhe në 1% të vëzhgimit në zonat tjera. Gjatë numërimit, u vërejt frikësim në 7 raste, ndërsa tensionimi dhe rrëmujja u raportuan në 16% të vëzhgimeve.

<sup>35</sup> Veçanërisht në komunat e Tetovës, Gostivarit, Vrapçishtës, Bërvenicës, Bogovinjes, Tearcës, Zajasit, Dibrës, Çairit, Sarajit, Çuçer-Sandevës dhe Haraçinës.

Në Banjicë të epërme, vendvotimet (0515, 0516) u mbyllën një ore pas fillimit zyrtar të votimit, meqenëse kutitë e votimit ishin vjedhur nga persona të armatosur si dhe të gjithë anëtarët e këshillit zgjedhor u përjashtuan nga vendvotimet. Edhe dy vendvotime tjera në Gostivar (0507, 0508) duhej të mbyllën në orën 10:25 min, meqenëse votimi u pengua nga persona të panjohur, të cilët i mbushën kutitë e votimit, vodhën materialin zgjedhor dhe i frikësuan anëtarët e këshillit zgjedhor. Në Saraj, një vendvotim (2431) nuk u hap në kohë, sepse anëtarët e këshillit zgjedhor vërejtën se gjysma e fletëvotimeve ishin zhdukur një natë më parë. Votimi ishte mbyllur në mëngjes edhe në komunën e Çuçer Sandevës (jashtë Shkupit), pasi që rreth 30 persona të panjohur kanë hyre në vendvotim, kanë frikësuar anëtarët e këshillit zgjedhor dhe vjedhur materialin zgjedhor.

Në dy raste, policia shpëtoi vëzhguesit e MNVZ-së (IEOM) nga vendvotimet në Poroj (në veri të Tetovës), dhe Haraçin (në verilindje të Shkupit), kur gjendja e sigurisë nuk mundësoi daljen e tyre të sigurt nga kjo zonë. Dy anëtarë të KSHZ-së të cilët kishin vizituar këtë zonë, në përpjekje për të hetuar manipulimet në ditën e zgjedhjeve në Poroj, poashtu patën nevojë për ndërhyrjen e policisë për t'i nxjerr.

Në një numër të madh të zonave, vëzhguesit e MNVZ-së vunë re mungesën e policisë në afërsi të vendvotimeve gjatë votimit (22%). Mungesa e policisë ishte edhe me e dukshme gjatë numërimit të votave; në 39% të numërimeve të vëzhguara, policia nuk e siguroi dhe as nuk e izoloi vendvotimin.

## **B. VOTIMI**

### **1. Votimi i hershëm**

Votimi i hershëm u zhvillua më 31 maj, një ditë para zgjedhjeve, për banorët e burgjeve dhe të zhvendosurit e brendshëm. Në të njëjtën ditë, votimi mobil u zhvillua për pacientët e shtrirë në spital dhe ato në shtëpi. MNVZ-ja vëzhgoi 54 raste të votimit të hershem, i cili në përgjithësi u administrua në mënyrë të mire. Shumica e këtyre votuesve ishin grupe të vogla, vetëm në katër raste numri i këtyre votuesve ishte më i madh se 50 veta. Vëzhguesit e MNVZ-së vunë re se në pese raste këshilli zgjedhor nuk kishte ofruar kushte adekuate për fshehtësinë e procesit të votimit të hershem, dhe në 24% të vëzhgimeve, rregullat e procesit të votimit nuk u respektuan në mënyrë të plotë. Megjithatë, vlerësimi i votimit të hershëm ishte pozitiv në përgjithësi.

### **2. Votimi në ditën e zgjedhjeve**

Në ditën e zgjedhjeve, vëzhguesit e MNVZ-së vizituan mbi 1,100 vendvotime. Votimi u vlerësua si i keq apo shumë i keq në 8% të të gjitha vëzhgimeve, duke treguar parregullsi serioze. Kishte një dallim të konsiderueshëm në mes të zonave të vendit të banuara me maqedonas etnik dhe atyre kryesisht me shqiptar etnik. Në zonat kryesisht me popullatë etnike shqiptare, vlerësimi ishte në mase të madhe më i keq, me 20% nga votimet e vëzhguara të vlerësuara si i keq apo shumë i keq; në zonat tjera votimi ishte vlerësuar si i keq apo shumë i keq në 2% të rasteve. Ndryshimi në mes të zonave ishte poashtu i dukshëm në proporcion me votimin familjar. Votimi familjar u vërejt në gjithsej 18% të vendvotimeve - 34% në zonat me shumicë etnike shqiptare dhe 10% në zonat tjera.

Vëzhguesit e MNVZ-së raportuan 30 raste në të cilat kishte tregues evident të mbushjes së kutive, të cilat, në përjashtim prej dyve, të gjitha ndodhen në zonat me shumicë shqiptare.

Sipas numërimit të vëzhguesve të MNVZ-së, disa anëtare të këshillit zgjedhor morën pjesë në mbushjen e kutive. Në një rast në Likovë, kur vëzhguesit e MNVZ-së arritën në vendvotim rreth mesditës, drynjët e kutive ishin thyer dhe afërsisht 90% e votuesve gjoja se kishin votuar. Njoftimet për nënshkrime identike në listën e votuesve u pranuan nga 3% e vendvotimeve të vëzhguara (34 raste), pothuajse të gjitha në zonat me shumicë shqiptare.

Vëzhguesit e MNVZ-së shënuan një prezence të madhe të personave të paautorizuar në vendvotime: kryesisht në zonat me shqiptar etnike në 16% të vëzhgimeve, dhe në 6% të zonave tjera. Për shembull, në vendvotimin 1013 (Likovë), aktivistë të PDSH-së u panë duke ndërhyrë në proces dhe duke i udhëzuar anëtarët e KZ-së dhe votuesit. Vërejtjet e MNVZ-së tregojnë një lidhje të fuqishme reciproke ndërmjet pranisë së personave të paautorizuar dhe vlerësimit të përgjithshëm për këtë vendvotim. Vendvotimet me prani të personave të paautorizuar, përgjithësisht morën vlerësim më negativ.<sup>36</sup> Në 12 vendvotime, një person i paautorizuar udhëzonte apo ndërhynte në proces në prani të vëzhguesve të MNVZ-së.

### C. NUMËRIMI

MNVZ-ja vëzhgoi numërimin në 111 vendvotime; numërimi u vlerësua si i keq ose shumë i keq në 15% prej tyre. Dallimi i dukshëm në mes të zonave me shumicë shqiptare dhe zonave tjera vazhdoi edhe gjatë numërimit të votave, ku 30% e numërimeve u vlerësuan si të këqija ose shumë të këqija në zonat të banuara me shqiptar etnik, për dallim nga 8% në zonat tjera.

Në 12 raste të vëzhguara, rezultatet nuk arritën të përputhen. Për shembull, në Bogovinjë (vendvotimi nr. 2129) përfaqësuesi i autorizuar i PDSH-së u pa duke i futur duart në listat e votimit dhe duke shqyer fletëvotimet për t'u siguruar që numrat të përputheshin. Disa vendvotime u mbyllën herët, përpara se të mbërrin vëzhguesit, në mënyrë që numërimi të mos shihet. Në rast të ngjashëm, në Svillare të epërme (2455), në periferi të Shkupit, rezultatet nuk u shpallen në vendvotim ndërsa KZ-ja nuk u gjet nga vëzhguesit e MNVZ-se, të cilët kishin ardhur për numërimin e votave. KZ-ja me në fund mbërrihu në KKZ, me dy orë vonesë, me rezultate të cilat tregonin një dalje prej 93%, pothuajse të gjitha në favor të PDSH-së.

### D. PËRLLOGARITJA

MNVZ-ja vëzhgoi përlllogaritjen e rezultateve në 73 nga 84 KKZ-të. Përlllogaritja ishte në përgjithësi e pastër dhe transparente me përfaqësues të autorizuar dhe vëzhgues të pranishëm të MOST-it. Vetëm dy KKZ u vlerësuan me 'keq' ose 'shumë keq'<sup>37</sup>, megjithëse tensionime dhe rrëmujë ishin vërejtur në 7 KKZ, kurse përlllogaritja u vlerësua si e paorganizuar mirë në 10 KKZ. Të dhënat nga rezultatet e protokollit të të gjitha vendvotimeve nuk u futën në databazë të kompjuterit në 6 KKZ. Përveç kësaj, në të gjitha rastet ku hyrja e të dhënave u realizua në një dhomë tjetër, vetëm vëzhguesit e MNVZ-së u lejuan ta shohin këtë proces.

Të vetmet raporte mbi një aktivitet në dukje të qëllimshëm të mashtrimit ishin nga KKZ-ja e Tetovës, ku shumë probleme kishin ndodhur në vendvotime gjatë ditës. Të paktën pesë KZ dolën vetëm me rezultate pjesërisht të kompletuara në protokollet e tyre; KKZ-të u ndihmuan KZ-ve në kompletimin e dokumentacionit në mënyrë që të përputhen pa një shqyrtim të

<sup>36</sup> Nëse ishte prezent një njeri i autorizuar, vlerësimi i përgjithshëm ishte negative (keq, deri më keq) në 27% të vendvotimeve, nëse person jo i autorizuar ishte prezent, numri bie deri në 5%.

<sup>37</sup> Tetovë dhe Saraj.

materialeve. Në Tetovë, vëzhguesve të MNVZ-së u është thënë vazhdimisht që të mos bëjnë pyetje dhe të ulen aty ku nuk mund ta shohin procesin. Vëzhguesit e MNVZ-së atje vërejtën se pesë vendvotime tregonin 90 deri 100% dalje në zgjedhje dhe se KZ-të dilnin me protokolle të panënshkruara dhe që pranoheshin nga KKZ-ja. Në Gostivar, për krahasim, vëzhguesit e MNVZ-së ishin dëshmitarë të grindjeve kur KKZ-ja refuzoi të përlllogarisë rezultatet e disa vendvotimeve. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it mori informacion nga anëtarët e dy KKZ-ve (Tetovë dhe Saraj) se ata kanë qenë të frikësuar nga zyrtarë të lartë ose nga anëtarë të KKZ-së për të pranuar protokolle të paplota apo të falsifikuara.

KSHZ-ja bëri të ditur se dalja në votime për zgjedhjet e parakohshme të 15 qershorit ishte 58%. Rezultatet e përlllogaritura në databazen e KSHZ-së treguan se në 75 nga 2741 vendvotime kishin numra jashtëzakonisht të larta të daljes në votime - shumica në zona për të cilat kishte njoftime për incidente të dhunës ose të mbushjes së kutive. Dy vendvotime në Poroj, nga cili vend vëzhguesit e MNVZ-së duhej të nxirreshin me ndihmën e policisë, treguan se 99 deri 100% të daljes në votime ku pothuajse të gjitha votat ishin hedhur për PDSH-në.

### **XIII. ZHVILLIMET POST-ZGJEDHORE**

#### **A. ZHVILLIMET POLITIKE**

Dhuna gjatë ditës së zgjedhjeve, përfshirë përdorimin e armëve, u dënua ashpër nga kryetari Branko Cërvenkovski dhe nga bashkësia ndërkombëtare. Megjithëse, rezultatet paraprake treguan se VMRO-DPMNE kishte fituar bindshëm, kryetari i partisë, Nikolla Gruevski, bëri të ditur se partia e tij do të fillojë bisedimet për koalicionin vetëm pasi të ishin zhvilluar zgjedhje demokratike në tërë vendin. Si kryeministër aktual, ai poashtu siguroi se rivotimi do të mbahet në të gjitha zonat e prekura nga incidentet e dhunshme.

Në deklaratat e tyre post-zgjedhore, të dy partitë shqiptare vazhdimisht akuzuan njëra-tjetrën se kishin vjedhur votat dhe se kishin përdorur dhunë. Kryetari i PDSH-së, Menduh Thaçi, vazhdimisht kërkoi dorëheqjen e rivalit të tij, Ali Ahmetit,<sup>38</sup> i cili, nga ana e tij, bënte thirrje për izolimin e PDSH-së dhe të kryetarit të saj.<sup>39</sup> Më 5 qershor, BDI-ja protestoi në mënyrë paqësore kundër dhunës në zgjedhje. PDSH-ja aplikoi retorikë të fuqishme, ndërsa në deklaratën e saj paralajmëroi se “kasaphana politike” të cilën BDI-ja e “mbijetoi” gjatë zgjedhjeve të 1 qershorit do të vazhdonte gjatë rivotimeve më 15 qershor dhe se BDI-ja do të mposhte bindshëm.<sup>40</sup>

MPB-ja informoi MVZ-në e OSBE/ODIHR-it se 164 padi penale ishin ngritur kundër autorëve të dhunës në ditën e zgjedhjeve, por se më pak se 25 persona ishin marrë në arrest si rezultat i këtyre përpjekjeve deri më 14 qershor. Këtu përfshihet edhe një zyrtar i lartë partiak i BDI-së, i cili u arrestua më 13 qershor.

<sup>38</sup> Menduh Thaçi: “Ahmeti hyri në politikë me krisma, Është vështirë që një subjekt i tillë ta kuptojë fuqinë e demokracisë e cila duhet të arrihet me votë, jo me armë » (Top Channel TV, 5 qershor).

<sup>39</sup> Deklaratë për shtyp nga BDI-ja, 5 qershor 2008.

<sup>40</sup> Zëdhënësi i PDSH-së, Adriatik Imeri, në konferencë për shtyp mbajtur më 11 qershor.

## B. ANKESAT DHE APELET POST-ZGJEDHORE

Pesë parti politike dhe koalicione të cilat kontestuan zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 1 qershorit parashtruan ankesa te KSHZ-ja, të cilat përfshinë 376 vendvotime. KSHZ-ja i shqyrtoi këto ankesa gjatë dy ditëve, në praninë e vëzhguesve të MVZ-së të OSBE/ODIHR-it, si dhe përfaqësuesve të autorizuar të parashtruesve të listave të kandidatëve, ndërsa këto u transmetuan drejtpërdrejt në televizion.

Gjatë hetimit të ankesave pas zgjedhjeve të 1 qershorit, KSHZ-ja vendosi kritere të fiksuara, me anë të të cilave do t'i haptë kutitë e votimit për t'i rishqyrtuar materialet. Kriteret përfshinin vendimin nëse përfaqësuesit e autorizuar ose këshillat zgjedhor kishin shkruar ankesa të hollësishme në protokolle dhe të shikojnë nëse ankesat e hollësishme ishin bërë në adresë të KKZ-së. Përveç shqyrtimit të ankesave, KSHZ-ja poashtu verifikoi nëse materialet zgjedhore kishin protokolle të panëshkruar ose të ndryshuar, mori parasysht informacionet shtesë nga zyrtarë zgjedhorë dhe i shqyrtoi rezultatet e vendvotimeve, të dyshimta për daljen e madhe në zgjedhje.

Si rezultat i këtij shqyrtimi, KSHZ-ja anuloi rezultatet e 197 vendvotimeve. 38 nga këto anulime u bënë *ex officio*, për faktin se votimi ishte pezulluar ose bazuar në vërejtjet e bëra nga e anëtarët e KSHZ-së. Vendvotimet e mbetura u anuluan për shkak të aktivitetit të pahijshëm: protokolle të pasakta ose të panëshkruara, listat e votuesve përmbajnë dëshmi për votim në vend të dikujt tjetër, apo numri i fletëvotimeve nuk është i barabartë me numrin e votuesve, të cilët kishin votuar. Nga 100 vendvotimet për të cilat u shqyrtuan materialet zgjedhore, KSHZ-ja gjeti dëshmi të mjaftueshme për anulimin e 94 prej tyre.

Shqyrtimi i tërthortë i materialeve zgjedhore dhe vendimet e marra shënuan një ndryshim të dukshëm në mënyrën se si KSHZ-ja i kishte shtruar ankesat dhe apelet post-zgjedhore dhe parregullsitë gjatë ditës së zgjedhjeve; KSHZ-ja asnjëherë më parë nuk i kishte shqyrtuar materialet gjatë procesit të ankesave dhe apeleve.

Tri parti e shfrytëzuan të drejtën e tyre për t'i apeluar këto vendime tek Gjykata Supreme. BDI-ja apeloj që të anulohen rezultatet në katër vendvotime, PDSH-ja për 110 vendvotime tjera si dhe kthimin e 76 rezultateve të anuluar, ndërsa Organizata sekrete revolucionare maqedonase (TMRO) për tërë zonat zgjedhore 4 dhe 5. Gjykata Supreme u nda në katër panele për të dhënë gjykim për apelimet. Tre panele mbështetën pjesën më të madhe të vendimeve KSHZ-së duke zhvleftësuar vetëm një, por paneli i katërt ktheu 11 vendime të KSHZ-së për anulimin e rezultatit të votimeve. Megjithëse ata theksuan se i kishin shqyrtuar materialet dhe se nuk kishin gjetur asnjë dëshmi e cila do të vërtetonte vendimin e KSHZ-së, paneli shqyrtoi tërësisht materialin e vetëm një vendvotimi. Për dallim nga procesi i ankesave në KSHZ, procesi i apelimave në Gjykatën Supreme nuk ishte i hapur për shqyrtim publik. Megjithatë, Gjykata Supreme për herë të parë vendimet e saja i vuri në dispozicion në faqen e saj të internetit.

## C. RIVOTIMET

Sipas Kodit Zgjedhor, nëse rezultati i vendvotimit anulohet dhe këto rezultate ndikojnë në shpërndarjen e përgjithshme të vendeve në Parlament, rivotimi duhet patjetër të mbahet 14 ditë pas zgjedhjeve.



Rivotimi më 15 qershor për zgjedhjet e parakohshme të 1 qershorit u mbajt në gjithsejtë 187 vendvotime, për 161,874 votues. Rivotimi përfshiu 19 KKZ<sup>41</sup>, kryesisht në zonat me shumicë shqiptare në vend. Rivotimi përfshiu 6% të gjithsejtë 2,976 vendvotimeve dhe 9% të të gjithë votuesve. Sipas Ministres së punëve të brendshme, gjysma e forcës policore prej 10,000 individëve ishte stacionuar për të siguruar një ambient pa dhunë.<sup>42</sup>

Vëzhguesit e MNVZ-së njoftuan për praninë e madhe të policisë rreth vendvotimeve, me skuadra të shumëfishta të njësiteve të ndryshme të policisë në secilin mjedis. Kjo gjë u dëshmuar si efikase në parandalimin e incidenteve të cilat ndodhën më 1 qershor. Megjithatë, në disa vendvotime, policia nuk pengoi numrin e madh të aktivistëve të partive politike për t'u mbledhur rreth tyre dhe për të krijuar një atmosferë kërcënuese për votuesit dhe zyrtarët e zgjedhjeve. Tensionimet dhe rrëmuja u vunë re jashtë 17 dhe brenda 12 vendvotimeve, ndërsa vëzhguesit njoftuan për 13 raste të frikësimit.

Vëzhguesit e MNVZ-së e vlerësuan votimin si përgjithësisht të mirë dhe shumë të mirë në 91% të rasteve. Ky rezultat ishte më pozitiv në krahasim me 20% të raporteve negative nga e njëjta zonë më 1 qershor. Sidoqoftë, fakti që 9% të vërejtjeve kanë qenë negative tregon se ka pasur një sërë problemesh dhe parregullsish gjatë procesit zgjedhor. Për shembull, materialet zgjedhore ishin vjedhur nga dy vendvotime në Tetovë, përpara se ato të hapen.<sup>43</sup> Gabimet procedurale që u vërejtën nënkuptojnë edhe mos kontrollimin, nga këshillat zgjedhor, të sprejit në gishtin e votuesit sapo të mbërrijë në vendvotim (në 17% të rasteve të vërejtura) si dhe mos spërkatjen me sprej të votuesit pasi ta kenë marrë fletëvotimin (në 10% të rasteve).

Vëzhguesit e MNVZ-së njoftuan për votim familjar në 47% të vendvotimeve ku u mbajt rivotimi. Kur duhej t'i elaborojnë vërejtjet e tyre, vëzhguesit e MNVZ-së sqaruan se në shumë raste burrat hynin në vendvotim me një grup grash dhe i udhëzonin ato gjatë tërë procesit të votimit.

Sipas raporteve të vëzhguesve, këta persona u "ndihmonin" shumë votuesve në 18% të rasteve. Prezenca e personave të paautorizuar në vendvotime, kryesisht aktivistë partiakë, ishte përsëri e konsiderueshme (23%).

MNVZ-ja mori njoftime nga 32 numërime të vëzhguara, ku tetë nga to u vlerësuan me keq ose shumë keq. Pati një prezencë të konsiderueshme të personave të paautorizuar (dhjetë raste), frikësim të vëzhguesve dhe anëtarëve të këshillit zgjedhor në dy raste dhe në nëntë raste shifrat e rezultateve nuk u përputhën. Sipas shifrave të përlllogaritura në tetë vendvotime, dalja në zgjedhje ishte mbi 80%.

Puna e KKZ-ve u vlerësua përgjithësisht si pozitive - dy raporte ishin negative, gjashtë të mira dhe katër shumë të mira. Edhe pse KKZ-të njoftuan se kanë qenë të kërcënuar, ata pohuan se këto kërcënime nuk kishin pasur asnjë ndikim për shkak të numrit të lartë të vëzhguesve ndërkombëtarë. Gjatë rivotimit, vëzhguesit e MNVZ-së ishin dëshmitarë të frikësimeve të tilla në komunën e Sarajit.

<sup>41</sup> Çair, Saraj, Studeniçan, Haraçin, Likovë, Butel, Kumanovë, Çuçer Sandevë, Gostivar, Dibër, Tetovë, Vrapçisht, Bogovinjë, Tearcë, Bërvenicë, Zhelinë, Zajas, Jegunovcë dhe Oslomej.

<sup>42</sup> 16 korrik 2008, takim me Ministren e punëve të brendshme Gordana Jankulovska.

<sup>43</sup> U vodhën fletëvotimet nga vendvotimet Nr. 1985, 1986, 1987 nga zyra e kujdestarit të klasës në shkollën e Reçicës. Votimi nuk filloi në ato vendvotime dhe KZ-të i dërguan materialet e mbetura të KKZ-ja.

#### XIV. ZHVILLIMET PAS RIVOTIMIT

Pas rivotimit, vetëm PDSH-ja dhe BDI-ja parashtruan ankesa. BDI-ja parashtroi 8 ankesa për 31 vendvotime në zonën 1 dhe në zonën 6. PDSH-ja parashtroi 16 ankesa për 148 vendvotime të zonave 1, 2 dhe 6. Megjithatë, në fillim të seancës, PDSH-ja i tërhoqi të gjitha 24 ankesat për zonën 2, meqenëse çfarëdo humbje atje mund t'i jepte njërin nga mandatet e saj koalicionit *Dielli*.

Seanca përsëri u zhvillua në mënyrë transparente, me praninë e përfaqësuesve të autorizuar dhe të vëzhguesve, si dhe transmetimit të drejtpërdrejtë në TV. KSHZ-ja përsëri arrin t'i vendosë kriteret për ekzaminimin e materialeve në nisje: duhej domosdo të kishte bazë për ankesat në hapësirën për vërejtje në protokollin ose raportet e KKZ-së, ndërsa ankesat domosdo të kishin të dhëna të mjaftueshme.

Pas hapjes së materialeve nga 13 vendvotime në bazë të ankesave, KSHZ-ja anuloi shtatë rezultate. Një vendvotim u anulua poashtu në bazë të asaj që protokollin nuk ishte nënshkruar. Të katër vendvotimet ku votimi nuk ishte mbajtur për shkak të materialit të humbur gjithashtu u anuluan *ex officio* (me forcën e ligjit). Dhjetë vendvotime të anuluar ishin në Njësinë Zgjedhore nr. 6 dhe ndikuan mbi një mandat. Dy ishin në Njësinë Zgjedhore nr. 2 dhe fillimisht nuk patën ndikim në asnjë mandat.

PDSH-ja i parashtroi Gjykatës Supreme 13 apeline, që përfshinin rezultate nga të gjitha 110 vendvotimet, duke pretenduar se kishte parashtruar ankesa të këshillat zgjedhor dhe KKZ-të, të cilat nuk ishin mbështetur. BDI-ja parashtroi katër ankesa që përfshinin gjashtë vendvotime, duke kërkuar pezullimin e anulimeve. Gjykata Supreme, këtë herë, i mbështeti të gjitha vendimet e KSHZ-së, duke i anuluar edhe tre vendvotime tjera, bazuar në apelimet e PDSH-së. Kur kombinohen me dy anulimet e para në Njësinë Zgjedhore nr. 1, këto anulime tjera ishin të mjaftueshme për të ndryshuar një mandatë, prandaj duhej të përsëritën. Kjo nxori numrin e përgjithshëm prej 15 vendvotimesh ku zgjedhjet duhej të përsëritën në njësinë zgjedhore nr. 1 dhe 6 më 29 qershor.

Përsëritja e rivotimit më 29 qershor nuk u monitorua nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it dhe nuk ndryshoi ndarjen e vendeve në parlament.

KSHZ-ja shqyrtoi katër ankesa në lidhje me rivotimin e dytë të mbajtur më 29 qershor, të cilat u parashtruan nga Partia për Prosperitet Demokratik (PPD). Pas shqyrtimit, KSHZ-ja i hodhi poshtë këto ankesa.

MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it u informua se që nga 26 qershori 40 rastet e shkeljeve zgjedhore që përfshijnë 150 persona ishin sjell para prokurorit publik. Nga të arrestuarit në lidhje me këto raste, 30 ishin ndaluar dhe 120 të tjerët të liruar në pritje të paraqitjes në gjyq. Nga të liruarit, njëri ishte zyrtar i lartë i BDI-së, i cili ishte arrestuar pak para rivotimit më 15 qershor dhe ishte liruar për të nisur mandatin e tij në parlament. Kjo pësojë pas tërheqjes së deklaratave të shtatë policëve, të cilët kishin bërë deklaratatë dëshmie kundër tij. Gjithsejtë 13 policë janë arrestuar dhe më vonë dhjetë janë ngarkuar për kundërvajtje në lidhje me zgjedhjet dhe përgjegjësitë e tyre policore.<sup>44</sup>

---

<sup>44</sup> Ljupco Todorovski, Drejtor i policisë, Ministria e punëve të brendshme 26 qershor 2008.

Sipas MPB-së, pengimi i procesit zgjedhor nga individë të ndryshëm rezultoi me padi penale kundër 171 personave. Prej datës 2 korrik, 61 individë gjenden në paraburgim dhe 48 raste janë zgjidhur. MPB-ja gjithashtu njoftoi se 13 policë janë suspenduar në pritje të hetimeve për shkeljet zgjedhore. Një zyrtar i lartë i MPB-së tha se procesi do të jetë i ngadalshëm meqenëse dëshmitarët janë të frikësuar, ndërsa prokurorët kanë vështirësi në qartësimin e kallëzimeve.

Në fund të korrikut u formua koalicioni qeveritar.<sup>45</sup> Koalicionin e formuan VMRO-DPMNE-ja me BDI-në dhe PAE-në.

## XV. REKOMANDIME

### A. KORNIZA LIGJORE

1. Kontradiktat midis Kodit Zgjedhor dhe ligjeve të reja për gjykatat dhe kontestet administrative që kanë të bëjnë me apelimin e vendimeve të KSHZ-së duhet të zgjidhen. Ndryshimet mund të përfshijnë edhe qartësime për atë se cilit organ duhet t'u drejtohen apelimet, si dhe të identifikojë se cilat veprime të organeve zgjedhore përbëjnë akte përfundimtare administrative të cilat mund të apelojnë. Për shkak të interpretimit të ngushtë të Gjykatës Supreme për kompetencat e saj gjatë zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të vitit 2008, rekomandohet që kjo kompetencë t'i jepet Gjykatës Administrative.
2. Dallimet në mes të Kodit Zgjedhor dhe Ligjit për Kundërvajtje duhet të zgjidhen, në mënyrë që KSHZ-ja të mund të ushtrojë të drejtë për të nisur procedurat kundër personave të cilët kryejnë kundërvajtje zgjedhore të shënuar në Kod.
3. Neni 73 i Kodit Zgjedhor, i cili parashikon që shkeljet zgjedhore të hedhen në gjyq në gjykatat themelore (me të drejtë apeli në Gjykatën e Apelit) duhet të elaborohen për të precizuar lëndën e ankesës, të pandehurit e mundshëm, formën ose format e padisë (civile, për kundërvajtje ose penale), si dhe këshillat juridike. Para zgjedhjeve, duhet të ketë informacion adekuat dhe trajnim në këtë drejtim për gjykatësit, si dhe t'u komunikohet profesionistëve ligjorë, shoqërisë civile dhe opinionit publik.
4. Dispozitat, në Kodin Zgjedhor, mbi financimin e fushatës duhet të zgjerohen - në përputhje me propozimet legjislative të Ministrisë së Drejtësisë - për t'u siguruar se të gjitha kufizimet për financimin e partive politike, në përgjithësi, përfshirë edhe kontributet jo-financiare (të mallrave dhe shërbimeve) të jenë të zbatueshme; një raport i përkohshëm financiar është i nevojshëm gjatë fushatës (i cili poashtu do të përfshijë çdo lloj fushate përpara periudhës për fushatë zgjedhore); ndërsa një revizion pozitiv i raporteve mbi financimin e fushatës të bëhet nga organet përkatëse të shtetit.
5. Neni 7 i Kodit Zgjedhor, i cili parashikon ndalesë për kandidatët të cilët kanë qenë të dënuar me burgim për me gjatë se gjashtë muaj, duhet të rishikohet për të përcaktuar kufizimet e panevojshme ose diskriminuese mbi të drejtën pasive të votës.
6. Paqartësitë tjera të mbetura dhe pa përputhshmëritë e Kodit Zgjedhor duhet të zgjidhen, përfshirë edhe:

<sup>45</sup> Parlamenti votoi për konfirmimin e Qeverisë së Nikolla Gruevskit më 26 korrik 2008.

- a) Neni 151.1-2, i cili parashikon që përsëritja e zgjedhjeve domosdo të mbahet në vendvotimet ku votimi është pezulluar për më tepër se tri orë, përveç nëse numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar atje nuk ndikon në rezultatin e njësisë zgjedhore. Megjithatë, neni 104.6 thekson se zgjedhjet duhet patjetër të përsëritën në vendvotime sa herë që votimi të jetë ndërprerë për këtë periudhë kohore.
  - b) Neni 151.1, parashikon që KSHZ-ja, KKZ-ja dhe Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit mund të anulojnë rezultatet e votimeve në një vendvotim. Megjithatë, kjo e drejtë nuk parashikohet në kompetencat e KKZ-së në nenin 37, i cili parashikon që KKZ-ja duhet të “intervenojë” në rast të shkeljeve ligjore nga ndonjë këshill zgjedhor.
  - c) Neni 148.1 u jep të drejtë parashtruesve të listave zgjedhore të ankohen për shkeljet gjatë votimit, mbledhjes së votave dhe përcaktimit të rezultateve; por paragrafi 2 i tij tregon se ankesat e tilla duhet patjetër të parashtrohen brenda 48 orëve nga mbyllja e votimit. Përmbledhja e votave nga KKZ-të dhe përcaktimi i rezultateve nga KSHZ-ja mund të përfundojnë pas kësaj kohe.
7. Nëse Gjykata Supreme vazhdon t’i marrë parasysh apelimet në lidhje me zgjedhjet, seancat duhet të mbahen publikisht.

## **B. ADMINISTRATA E ZGJEDHJEVE**

8. Vëmendje urgjente duhet t’i kushtohet rekrutimit të të gjithë stafit të nevojshëm të ekspertëve të KSHZ-së, në mënyrë që komisioni të funksionojë si një organ plotësisht i pavarur. Kjo duhet të përfshijë stafin ligjor për t’u marrë me ankesat dhe për të nxitur hetimin e të gjitha shkeljeve në ditën e zgjedhjeve.
9. Përderisa rekomandohet që anëtarët e administratës zgjedhore të zgjidhen me short në kompjuter, rekomandohet që posti i kryetarit të KKZ-së të caktohet nga radhët e anëtarëve të zgjedhur me short nga KSHZ-ja, ose të zgjidhen nga anëtarët e KKZ-së, pas zgjedhjes së tyre me short.
10. Dispozitat e punësimit në shërbimin civil ose publik duhet të ndryshohen për t’u lejuar anëtarëve të KKZ-së të lirohen nga detyrat e tyre në punë për një kohë të mjaftueshme para zgjedhjeve, në mënyrë që t’i kryejnë detyrat e tyre në mënyrë efikase. Atyre të cilët vijnë nga jashtë vendbanimeve të tyre duhet t’u jepet kohë adekuatë për udhëtim si dhe kompensim për harxhimet e bëra.
11. KSHZ-ja duhet t’i definojë më mirë procedurat e KKZ-së për të manovruar me përllogaritjen në ditën e zgjedhjeve, përfshirë edhe: si të veprohet në rast të mospërputhjes së rezultatit në një vendvotim; si dhe kur të urdhërojë rinumërimin e votave; dhe të shpjegojë më qartë të drejtën e të gjithë vëzhguesve dhe përfaqësuesve të autorizuar për qasje të plotë në tërë procesin, përfshirë edhe shënimin e të dhënave.
12. Duhet të përgatitën programe të mëtutjeshme trajnimi. Trajnimi i KKZ-ve duhet të zbatohet në kohën midis cikleve të zgjedhjeve, ndërsa mund të përfshijë tema siç janë: manovrimi me përllogaritjen dhe kontrollimi i protokolleve, logjistika dhe financat,

komunikimi me këshillat zgjedhor dhe trajtimi i ankesave dhe urgjencave në ditën e zgjedhjeve. Trajnimi i këshillave zgjedhor duhet të mbulojë procedurat në ditën e zgjedhjeve, mbushjen e protokolleve, të drejtat e vëzhguesve dhe përfaqësuesve të autorizuar si dhe trajnimi tashmë i propozuar për parandalimin e votimit për tjetër njeri dhe votimit familjar. Trajnimi për policinë në ditën e zgjedhjeve duhet të vazhdojë dhe duhet të plotësohet duke u marrë hollësisht me rolin e oficerit jashtë vendvotimit - veçanërisht sepse ka të bëjë me trajtimin e grumbullimit rreth vendvotimit dhe sigurimit të tij para fillimit të procesit të votimit. Trajnues të posaçëm, të punësuar për zhvillimin dhe mbajtjen e trajnimit, do të ndihmonin për sigurinë në efikasitetin e tij.

13. Informimi dhe edukimi i votuesit mund të përmirësohet. Duhet të ketë më tepër informacion për vendndodhjen dhe kufijtë e vendvotimit në nivel lokal. Në nivel shtetëror, KSHZ-ja duhet të ketë buxhet më të madh që të mund t'i informojë më mirë votuesit për zgjedhjet dhe t'i trajtojë çështjet kryesore. Kjo do të ishte veçanërisht e rëndësishme për të ndihmuar në rindërtimin e besimit të votuesit.
14. Megjithëse rekomandohet që konkurrentët politikë t'i autorizojnë përfaqësuesit e tyre dhe t'i njoftojnë organet përkatëse të menaxhimit të zgjedhjeve për identitetin e tyre, duhet të ekzistojë një lloj metode për identifikimin e partisë politike dhe përfaqësuesve të kandidatit në vendvotime. KKZ-ja duhet ta marrë parasysh mundësinë e lëshimit të akreditimeve me numrin specifik të vendvotimit në të për secilin përfaqësues të autorizuar; personave pa akreditim nuk duhet t'u lejohet hyrja.

#### **C. REGJISTRI I VOTUESVE**

15. Duhet të bëhet shqyrtim dhe kontroll i tërësishëm në regjistrin e votueseve.
16. Procesi i ndërrimit të të dhënave për regjistrim të vendbanimit duhet të shqyrtohen me qëllim që të bëhet procedura më e shkurtër dhe më e thjeshtë.
17. Kufijtë zgjedhor për disa vendvotime përkatëse duhet të shqyrtohen në intervale të rregullta, ndërsa në ato vende ku numri i votuesve është nën pragun minimal të dakorduar duhet të bashkohen me vendvotimet e tjera.

#### **D. FUSHATA ZGJEDHORE**

18. Definicioni për heshtjen gjatë fushatës duhet të elaborohet që të përfshijë edhe afishet dhe fletushkat. Megjithatë, duhet të ndërpritet praktika që të mos lejohet asnjë informatë për votuesit ose njoftime të tjera nga administrata zgjedhore gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.
19. Të gjitha materialet zgjedhore të shtypura duhet të përmbajnë informata të verifikuara për atë se kush i ka porositur dhe prodhuar materialet për fushatë. Të gjitha reklamat transmetuese të fushatës duhet qartë të shënohen si të tilla dhe të kenë informata për atë se kush i ka siguruar fondet për video klipin.
20. Autoritetet duhet të japin më shumë mund për të hetuar dhe dënuar incidentet e lidhura me dhunën gjatë zgjedhjeve dhe keqpërdorimeve gjatë periudhës së fushatës. Kjo përfshin edhe hetimin e atyre çështjeve të ngritura nga Komisioni shtetëror për anti-korrupsion.

Gjithashtu, duhet të bëhen përpjekje të sigurohet se hapi i tillë nuk perceptohet i politizuar ose i anshëm ndaj asnjë grupi ose partie.

21. Roli dhe funksionimi i partisë dhe strukturave të shtetit nuk duhet të mjegullohen. Duhet bërë më shumë përpjekje në lidhje me këtë dhe në lidhje me çështjet e identifikuara gjatë fushatës zgjedhore.

#### **E. DITA E ZGJEDHJEVE DHE PROCEDURAT E VOTIMIT**

22. Dispozita për vulosje të dyfishtë të fletëvotimit duhet të shqyrtohet. Sepse vula e dytë mund të shpien në situatë ku keqpërdoret fshehtësia e votës.
23. Praktika e shtypjes së numrit të njëjtë të fletëvotimeve sa edhe numri i votuesve, dhe hapja e paketave për të marrë fletëvotimet për votim të hershëm dhe votim mobil duhet të ndryshon. Kjo ka shpjer deri të mungesa e sigurisë së fletëvotimeve dhe anëtarët e KY-së nuk kanë mundësi të dinë se sa fletëvotime janë marrë. Në vend të kësaj, çdo vendvotimi duhet t'i jepet numër plotësues i fletëvotimeve për fletëvotimet tepricë, dhe KKZ-ve mund t'u jepet një tjetër tom me fletëvotime, me numër serik special që të përdoret për votim të parakohshëm.
24. Përpjekjet për të kërkuar përgjegjësi të shkelësit e ligjit duhet të vazhdojë. Duhet siguruar që zyrtarët e administratës së zgjedhjeve të cilët janë dënuar për shkelje të mos rriemërohen në KZ-të dhe KKZ-të gjatë zgjedhjeve të ardhshme.

#### **F. MEDIAT**

25. Me qëllim që të sigurohet qasje e barabartë në mediat, siç kërkohet me ligj, duhet t'u llogariten tarifat e njëjta të gjithë pjesëmarrësve në garë për kohë transmetimi të barabartë. Kjo është ndryshe nga praktika e tashme ku jepet një tarifë bazë e barabartë për të gjithë dhe pastaj negociohen zbritje të cilat nuk bëhen publike.
26. Rregulla për mbulimin e fushatës duhet të përfshihen në ligjin për veprimtari për radiodifuzion dhe Kodin Zgjedhor, në vend se Parlamenti të sjellë rregulla të reja për çdo zgjedhje.
27. Duhet të vendosen procedura me të cilat Këshilli për radiodifuzion do të mund të sanksionojë transmetuesit nëse i thyjnë rregulloret për media gjatë periudhës së fushatës në mënyrë efektive dhe në kohë. Procedurat duhet të mundësojnë trajtimin e shpejtë të ankesave me qëllim që të ketë zgjidhje të shpejtë të tyre.
28. Duhet të ndërmerren hapa për të siguruar se mblidhen taksat e radiodifuzionit dhe se institucionet të cilat financohen me taksat e radiodifuzionit i pranojnë të ardhurat në kohë.

## SHTOJCA 1 – REZULTATET PËRFUNDIMTARE<sup>46</sup>

Në bazë të rezultateve përfundimtare të procesit zgjedhor, 63 mandate i fitoi koalicioni VMRO-DPMNE, 27 koalicioni *Dielli*, 18 Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI), 11 Partia Demokratike Shqiptare (PDSH), dhe 1 Partia për Ardhmëri Evropiane (PAE). Gjatë korrikut të vonshëm, koalicioni qeveritar u formua prej VMRO-DPMNE-së, së bashku me BDI-në dhe PAE-në.

### Dalja e votuesve në zgjedhje:

- Zgjedhjet parlamentare të 1 qershorit, 57.99%
- Rivotimet e 15 qershorit në 187 vendvotime - 48.9 %
- Dalja e përmbledhur e votueseve në të gjitha fazat e zgjedhjeve 57.06%

Partia	Rezultati pas 1 qershor 2008			Rezultati pas 15 qershor 2008		
	Numri i votuesve	%	Vende në Kuvend	Numri i votuesve	%	Vende në Kuvend
Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE	482 842	46.7%	64	481 602	47%	63
Koalicioni <i>Dielli</i>	233 371	22%	28	233 362	23%	27
BDI	111 407	11%	13	125 997	12%	18
PDSH	105 293	10%	13	83 678	8%	11
PAE	14 502	1%	1	14 473	1%	1

<sup>46</sup>

Komisioni shtetëror zgjedhor, rezultatet përfundimtare:

[http://www.sec.mk:90/english/index.php?option=com\\_content&view=article&id=64&Itemid=74](http://www.sec.mk:90/english/index.php?option=com_content&view=article&id=64&Itemid=74)

## RRETH OSBE/ODIHR-it

Zyra për institucione demokratike dhe të drejtat e njeriut (OSBE/ODIHR) është institucioni kryesor i OSBE-së që u ndihmon shteteve pjesëmarrëse “për të siguruar respekt të plotë për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, t’i përmbahen sundimit të ligjit, të promovojnë parimet e demokracisë dhe (...) të ndërtojnë, përforcojnë dhe t’i mbrojnë institucionet demokratike, si dhe të promovojnë tolerancë në të shoqërinë” (1992, Dokument i Samitit të Helsinkit). Kësaj i referohet si dimensionit njerëzor i OSBE-së.

OSBE/ODIHR-i, me seli në Varshavë (Poloni), u krijua si zyrë për zgjedhje të lira në Samitin e Parisit të vitit 1990 dhe filloi me punë në maj të vitit 1991. Një vit më vonë, emri i Zyrës u ndryshua që të reflektojë mandatin e zgjeruar meqë i përfshiu edhe të drejtat e njeriut dhe demokratizimin. Sot ka një staf punues prej 130 individëve.

OSBE/ODIHR-i është Agjenci udhëheqëse në Evropë në fushën e **vëzhgimit të zgjedhjeve**. Çdo vit, bën koordinimin dhe organizon vendosjen e mijëra vëzhguesve për vlerësimin nëse zgjedhjet në rajonin e OSBE-së janë mbajtur në pajtim me Obligimet e OSBE-së, standardeve të tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike dhe legjislacionit nacional. Metodologjia e tyre unike siguron depërtim të thellë në procesin zgjedhor në tërësi. Nëpërmjet projekteve për ndihmë, OSCE/ODIHR-i u ndihmon shteteve pjesëmarrëse të përmirësojnë kornizën e tyre zgjedhore.

Aktivitetet e Zyrës për **demokratizim** përfshijnë: sundimin e ligjit, mbështetje të legjislacionit, udhëheqje demokratike, migracion dhe të drejtën e lëvizjes së lirë dhe barazi gjinore. OSBE/ODIHR-i zbaton një numër të programeve të planifikuara për asistencë gjatë vitit, me qëllim të zhvillimit të strukturave demokratike.

OSBE/ODIHR-i gjithashtu i ndihmon shtetet pjesëmarrëse në plotësimin e obligimeve të tyre për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut dhe liritë themelore që përmbahen në përkushtimet e dimensionit njerëzor të OSBE-së. Kjo arrihet duke punuar me partnerë të ndryshëm në drejtim të kultivimit të bashkëpunimit, ndërtimit të kapacitetit dhe sigurimit të ekspertizës në fusha tematike duke përfshirë të drejtat e njeriut gjatë luftës kundër terrorizmit, rritjen e mbrojtjes së të drejtave të njeriut të personave të trafikuar, arsimim dhe trajnim për të drejtat e njeriut, vëzhgim dhe raportim mbi të drejtat e njeriut, si dhe të drejtat e njeriut të grave dhe siguria.

Në fushën e **tolerancës** dhe **jo-diskriminimit**, OSBE/ODIHR-i u siguron mbështetje shteteve pjesëmarrëse në përforcimin e përgjegjes së tyre ndaj krimit të urrejtjes dhe incidenteve të racizmit, ksenofobisë, anti-semitizmit, dhe formave të tjera të mos-tolerancës.

Aktivitetet e OSBE/ ODIHR-it në lidhje me tolerancën dhe mos-diskriminimin fokusohen në fushat që vijojnë: legjislacioni, trajnime për zbatim të ligjit, vëzhgim, raportim dhe ndjekje të përgjigjes ndaj krimeve dhe incidenteve të motivuara nga urrejtja; si dhe aktivitete edukative për promovimin e tolerancës, respektit dhe mirëkuptimit reciprok.

OSBE/ODIHR-i i këshillon shtetet pjesëmarrëse mbi politikën e tyre ndaj Romëve dhe Sintive. Bën promovimin e ndërtimit të kapaciteteve dhe rrjeteve midis bashkësive të Romëve dhe Sintive, dhe inkurajon pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Romëve dhe Sintive në organet ku krijohen politikën.

Të gjithë aktivitetet e ODIHR-it zhvillohen me koordinim dhe bashkëpunim të ngushtë me shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, Institucionet e OSBE-së dhe operacioneve në terren, si dhe me organizata të tjera ndërkombëtare.

Për më shumë informata, e keni në dispozicion internet faqen e ODIHR-it: ([www.osce.org/odihr](http://www.osce.org/odihr)).